

VENDIM
PER RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot, më datë 11.05.2006, unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqsor -Tiranë, Marjana Dedi, pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Shoqëria "Raiffeisen Leasing" Sh.a., (ne formim e sipër), e përfaqësuar nga Znj. Majlinda Hakani, në cilësinë e Drejtores së Shoqërisë, si dhe dokumentet e tjera bashkëngjitur,

KONSTATOVA:

Raiffeisen Bank sh.a., ("RBAL"), një bankë që është themeluar dhe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe **Raiffeisen - Leasing International Gesellschaft m.b.h.**, ("RLI"), një shoqëri që është themeluar dhe funksionon sipas ligjeve të Austrisë, kanë themeluar një shoqëri anonime sipas së drejtës shqiptare që do të ushtrojë veprimtarinë e saj në fushën e qirasë financiare.

Emërtimi I Shoqërisë është "**Raiffeisen Leasing**" sh.a., dhe kohëzgjatja e saj është e pakufizuar.

Shoqëria e ka selinë në adresën Rr. Kavajës, Tiranë.

Objekti I veprimtarisë së Shoqërisë është:

- a) ushtrimi I veprimtarisë së qirasë financiare, qiradhënia financiare e sendeve të luajtshme dhe pasurive të paluajtshme, dhe
- b) blerja e sendeve me qëllim rishitjen e tyre, dhe
- c) financimi ose kredidhënia në funksion të veprimtarisë së qirasë financiare, dhe
- d) Të gjitha veprimtaritë e tjera të biznesit të lidhura apo plotësuese, të cilat mund të jenë të nevojshme (duke përfshirë ndër të tjera, shërbime regjistrimi, ndërmjetësim në sigurime, menaxhim ndërtimesh dhe të infrastrukturave që lidhen me to për pasuri të paluajtshme ose kryerja e shërbimeve të tjera që lidhen me objektet e dhëna në qira financiare).

Kapitali I Shoqërisë është 123 000 000 ALL (Lekë Shqiptare) (njëqind e njëzetetë milionë lekë) ose 1 000 0000 Euro (një milionë Euro) dhe ndahet në 1000 (njëmijë) aksione me vlerë nominale prej 123 000 ALL (njëqind e njëzet e tre mijë lekë) secila ose 1 000 Euro (njëmijë Euro) secila. Cdo aksion është I pandashëm dhe përbën të drejtën e një vote.

Aksionet ndahen si më poshtë:

- a) **RBAL: 750** aksione (*shtatëqind e pesëdhjetë*) me vlerë nominale 92 250 000 ALL (*nëntëdhjetë e dy milionë dyqind pesëdhjetë mijë lekë*) ose 750 000 Euro (*shtatëqind pesëdhjetë mijë*).
- b) **RLI: 250** aksione (*dyqind e pesëdhjetë*) me vlerë nominale 30 750 000 ALL (*tridhjetëmilionë shtaëqind e pesëdhjetë mijë Lekë*) ose 250 000 Euro (*dyqind pesëdhjetë mijë*).

Aksionet janë nënshkruar nga aksionerët dhe janë paguar totalisht prej tyre në llogarinë bankare n. 1000 555 551, pranë Bankës Raiffeisen Bank sh.a. që është celur për këtë qëllim.

Organet Drejtuese të Shoqërisë janë:

- **Asambleja e Aksionerëve;**
- **Këshilli Mbikqyrës;**
- **Drejtoria.**

Organizimi dhe funksionimi i këtyrë organeve rregullohet në statutin e Shoqërisë, ku parshikohen gjithashtu rregullat e funksionimit të Shoqërisë.

Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 3 (tre) ose më shumë anëtarë. Personat e mëposhtëm janë emëruar anëtarë të Këshillit Mbikqyrës të parë të Shoqërisë:

1. **Z. Dieter Schiedl**, shtetas austriak, lindur në Gmuend, Austri, më 11.09.1967, banues në Huglgasse 11/7, 1150 Vienë, Austri, me pas. N. A 0087535;
2. **Z. Steven Grunerud**, shtetas kanadez, lindur në Vankuver, Kanada, më 03.04.1963, banues në Tiranë, Shqipëri, me pas. N. BC16338;
3. **Z. Robert Wright**, shtetas anglez, lindur në Birkenhead, Angli, më 25.10.1956, banues në Tiranë, Shqipëri, me pas. N. 093121379

Drejtoria përbëhet nga një ose më shumë Drejtorë. **Znj. Majlinda Hakani**, shtetase shqiptare, lindur më 27 Maj 1967, në Tiranë, banuese në Rr. "Myslym Shyri", Pall. 56/1/7, Tiranë, Shqipëri, me nr. pashaporte n. 0777898 është emëruar si Drejtore e Shoqërisë.

Ekspertë Kontabël i autorizuar për Shoqërinë është emëruar shoqëria e të drejtës shqiptare KPMG Albania sh.p.k.

Kerkuesi i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqsor - Tiranë regjistrimin si person juridik të shoqërisë Raiffeisen Leasing sh.a.;

PËR KËTO ARSYE

meqënëse janë paraqitur të gjitha dokumentet e nevojshme dhe meqënëse unë i gjej ato të plotësuar në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 28.01.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7632, datë 04.11.1992 "Për Dispozitat që rregullojnë Pjesën e Parë të Kodit Tregtar",

VENDOSA:

- Pranimin e kërkesës.
- Regjistrimin si person juridik te Shoqërisë Raiffeisen Leasing sh.a. ne Rregjistrin Tregtar te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

Emërtimi I Shoqërisë është “**Raiffeisen Leasing**” sh.a., dhe kohëzgjatja e saj është e pakufizuar.

Shoqëria e ka selinë në adresën Rr. Kavajës, Tiranë.

Objekti I veprimtarisë së Shoqërisë është:

- a) ushtrimi I veprimtarisë së qirasë financiare, qiradhënia financiare e sendeve të luajshme dhe pasurive të paluajshme, dhe
- b) blerja e sendeve me qëllim rishitjen e tyre, dhe
- c) financimi ose kredidhënia në funksion të veprimtarisë së qirasë financiare, dhe
- d) Të gjitha veprimtaritë e tjera të biznesit të lidhura apo plotësuese, të cilat mund të jenë të nevojshme (duke përfshirë ndër të tjera, shërbime regjistrimi, ndërmjetësim në sigurime, menaxhim ndërtimesh dhe të infrastrukturave që lidhen me to për pasuri të paluajshme ose kryerja e shërbimeve të tjera që lidhen me objektet e dhëna në qira financiare).

Aksionarë të Shoqërisë janë **Raiffeisen Bank** sh.a., (“**RBAL**”), një bankë që është themeluar dhe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe **Raiffeisen - Leasing International Gesellschaft m.b.h.**, (“**RLI**”), një shoqëri që është themeluar dhe funksionon sipas ligjeve të Austrisë.

Kapitali I Shoqërisë është 123 000 000 ALL (Lekë Shqiptare) (*njëqind e njëzetetrem milionë lekë*) ose 1 000 0000 Euro (*një milionë Euro*) dhe ndahet në 1000 (*njëmijë*) aksione me vlerë nominale prej 123 000 ALL (*njëqind e njëzet e tre mijë lekë*) secila ose 1 000 Euro (*njëmijë Euro*) secila. Cdo aksion është I pandashëm dhe përbën të drejtën e një vote.

Aksionet ndahen si më poshtë:

- a) **RBAL: 750** aksione (*shtatëqind e pesëdhjetë*) me vlerë nominale 92 250 000 ALL (*nëntëdhjetë e dy milionë dyqind pesëdhjetë mijë lekë*) ose 750 000 Euro (*shtatëqind pesëdhjetë mijë*).
- b) **RLI: 250** aksione (*dyqind e pesëdhjetë*) me vlerë nominale 30 750 000 ALL (*tridhjetëmilionë shtaëqind e pesëdhjetë mijë Lekë*) ose 250 000 Euro (*dyqind pesëdhjetë mijë*).

Aksionet janë nënshkruar nga aksionerët dhe janë paguar totalisht prej tyre në llogarinë bankare n. 1000 555 551, pranë Bankës Raiffeisen Bank sh.a.

Organet Drejtuese të Shoqërisë janë:

- **Asambleja e Aksionerëve;**
- **Këshilli Mbikqyrës;**
- **Drejtoria.**

Organizimi dhe funksionimi i këtyrë organeve rregullohet në statutin e Shoqërisë, ku parshikohen gjithashtu rregullat e funksionimit të Shoqërisë.

Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 3 (tre) ose më shumë anëtarë. Personat e mëposhtëm janë emëruar anëtarë të Këshillit Mbikqyrës të parë të Shoqërisë:

1. **Z. Dieter Schiedl**, shtetas austriak, lindur në Gmuend, Austri, më 11.09.1967, banues në Huglgasse 11/7, 1150 Vienë, Austri, me pas. N. A 0087535;
2. **Z. Steven Grunerud**, shtetas kanadez, lindur në Vankuver, Kanada, më 03.04.1963, banues në Tiranë, Shqipëri, me pas. N. BC16338;
3. **Z. Robert Wright**, shtetas anglez, lindur në Birkenhead, Angli, më 25.10.1956, banues në Tiranë, Shqipëri, me pas. N. 093121379.


Drejtoria përbëhet nga një ose më shumë Drejtorë. **Znj. Majlinda Hakani**, shtetase shqiptare, lindur më 27 Maj 1967, në Tiranë, banuese në Rr. "Myslym Shyri", Pall. 56/1/7, Tiranë, Shqipëri, me nr. pashaporte n. 0777898 është emëruar si Drejtore e Shoqërisë.

Ekspertë Kontabël i autorizuar për Shoqërinë është emëruar shoqëria e të drejtës shqiptare KPMG Albania sh.p.k.

Tiranë, 15.05/2006

GJYQTARE

MARJANA DEDI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR TIRANE
Nr. 35733 / **VENDIMIT**

1

VENDIM
I
GJYQTARIT TE VETEM

Sot, me 12.09- 2007, Une gjyqtarja e vetme Marjana (DEDI) SHEGANI, prane Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane pasi shqyrtova kerkesen e Drejtores se Raiffeisen Leasing Sh.a, Zj.Majlinda HAKANI dhe dokumentacionin e paraqitur nga ajo,

KONSTATOVA

Shoqeria Raiffeisen Leasing sh.a. eshte regjistruar ne regjistrin tregtar me vendimin nr.35733, date 15.05.2006 te Gjykates e Rrethit Gjyqsor Tirane.

Ne date 15.05.2007, eshte mbledhur Keshilli Mbikqyres i Raiffeisen Leasing sh.a., konform procedures te parashikuar ne piken 24 dhe 25 te Kreut VI te statutit te kesaj shoqerie.

Keshilli Mbikqyres, bazuar ne piken 33 dhe 42 te Kreut VII te Statutit ka vendosur te emeruje nje anetar te ri te Drejtorise se Raiffeisen Leasing. Ky keshill ka vendosur gjithashtu qe, anetari i ri emeruar, Z.Gent Sejko do te kete dhe detyren e Zv.Kryetarit te Drejtorise.

Kjo shoqeri ka depozituar prane Gjykates kerkesen dhe dokumentacionin perkates per regjistrimin e Vendimit te Keshillit Mbikqyres te Raiffeisen Leasing para dates se fillimit te regjistrimeve nga QKR dhe gjykata ka filluar shqyrtimin e dokumentacionit te paraqitur.

Ne keto kushte si dhe duke qene se shoqeria nuk e ka terhequr kerkesen e saj per depozitim e vendimit te keshillit te saj mbikqyres, bazuar ne piken 8 te Nenit 75 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", gjykoj se per kete kerkese duhet te shprehet kjo gjykate.

Mbas shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur, gjej kete dokumentacion te plote dhe konform dispozitave ligjore per shoqerite tregtare dhe si rrjedhim vleresoj se kerkesa duhet pranuar,

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit Nr.7638 dt.19.11.1992 “ Per Shoqerite Tregtare”, Ligjit Nr.7667 dt.28.01.1993 “ Per Regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare” si dhe Ligjit nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit“,


VENDOSA

- Pranimin e kerkeses.
- Regjistrimin e ne regjistrin tregtar te Vendimit te Keshillit Mbikqyres te Raiffeisen Leasing, te dates 15.05.2007, per emerimin si anetar te Drejtorise te Z.Gent Sejko dhe caktimin e tij ne detyren e Zv. Kryetarit te Drejtorise.
- Te behen shenimet e duhura prane regjistrin tregtar.

GJYQTARE

MARJANA (DEDI) SHEGANI





VENDIM

I GJYQITARIT TË VETËM

Sot, më datë 1. 10 .2004, unë gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Znj. Majlinda Dogga, pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Bankës së Kursimeve Sh.A., Z. Števen Grunerud, si dhe dokumentet e tjera bashkëngjitur kërkesës,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria “Banka e Kursimeve” Sh.A. është krijuar si person juridik në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë më datë 11 dhjetor 1992 në përputhje me ligjin nr. 7560, datë 28 prill 1992 “Për Sistemin Bankar në Republikën e Shqipërisë”, dhe është regjistruar si shoqëri anonime në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 17426, datë 10 Korrik 1997. Me vendime te ndryshme janë bere ndryshime ne aktet e depozituara prane regjistrit tregtar.

Më datë 02.08.2004, në Tiranë, u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerit të Vetëm të shoqërisë “Banka e Kursimeve” Sh.A, në të cilën, ndër të tjera, u

VENDOS:

1. Të rritet kapitali themeltar i Bankës së Kursimeve Sh.A. nga 700.000.000 (shtatëqind milion) Lekë në 3.194.832.000 (tre miliard e njëqind e nëntëdhjetë e katër milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë) Lekë.
2. Pagesa e rritjes së kalitalit themeltar sa më sipër do të bëhet nëpërmjet përfshirjes në kapital të shumës që i korrespondon llogarisë “Fitime të mbartura” të Bankës së Kursimeve Sh.A. në vlerën prej 2.494.832.000 (dy miliard e katërqind e nëntëdhjetë e katër milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë) Lekë.
3. Kapitali i Bankës së Kursimeve Sh.A. është 3.194.832.000 (tre miliard e njëqind e nëntëdhjetë e katër milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë) Lekë i ndarë në 7.000 (shtatë mijë) aksione nominative me një vlerë nominale prej 456.404,57 (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e katër presje pesëdhjetë e shtatë) Lekë secila.



Të emërohet si ekspert kontabël i autorizuar i Bankës së Kursimeve Sh.A. për vitin financiar 2004 shoqëria "Deloitte & Touche" Sh.p.k, Tiranë.

Të miratohet ndryshimi i emrit të Bankës nga "Banka e Kursimeve" Sh.A. në "Raiffeisen Bank" Sh.A, duke filluar nga data 1 tetor 2004.

Të miratohet ndryshimi i adresës së selisë ligjore të Bankës së Kursimeve Sh.A. nga "Rr. "Dëshmorët e 4 Shkurtit" nr. 6, Tiranë" në "Rr. e Kavajës, Tiranë".

PËR KËTO ARSYE

Meqënëse janë paraqitur të gjitha dokumentat e nevojshme dhe meqënëse unë i gjej ato plotësisht në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 28.01.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7632, datë 04.11.1992 "Për Dispozitat që Rregullojnë Pjesën e Parë të Kodit Tregtar",

VENDOSA:

- Pranimin e kërkesës.
- Depozitimn në Regjistrin Tregtar, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, të Vendimit Asamblesë së Jashtëzakonshme të Bankës së Kursimeve Sh.A., me datë 02.08.2004 ku u vendos:
 1. Të rritet kapitali themeltar i Bankës së Kursimeve Sh.A. nga 700.000.000 (shtatëqind milion) Lekë në 3.194.832.000 (tre miliard e njëqind e nëntëdhjetë e katër milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë) Lekë.
 2. Pagesa e rritjes së kalitalit themeltar sa më sipër do të bëhet nëpërmjet përfshirjes në kapital të shumës që i korrespondon llogarisë "Fitime të mbartura" të Bankës së Kursimeve Sh.A. në vlerën prej 2.494.832.000 (dy miliard e katërqind e nëntëdhjetë e katër milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë) Lekë.
 3. Kapitali i Bankës së Kursimeve Sh.A. është 3.194.832.000 (tre miliard e njëqind e nëntëdhjetë e katër milion e tetëqind e tridhjetë e dy mijë) Lekë i ndarë në 7.000 (shtatë mijë) aksione nominative me një vlerë nominale prej 456.404,57 (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e katër presje pesëdhjetë e shtatë) Lekë secila.
 4. Të emërohet si ekspert kontabël i autorizuar i Bankës së Kursimeve Sh.A. për vitin financiar 2004 shoqëria "Deloitte & Touche" Sh.p.k, Tiranë.
 5. Të miratohet ndryshimi i emrit të Bankës nga "Banka e Kursimeve" Sh.A. në "Raiffeisen Bank" Sh.A, duke filluar nga data 1 tetor 2004.



Të miratohet ndryshimi i adresës së selisë ligjore të Bankës së Kursimeve Sh.A. nga "Rr. "Dëshmorët e 4 Shkurtit" nr. 6, Tiranë" në "Rr. e Kavajës, Tiranë".

Urdhërimin e zyrës së Regjistrit Tregtar të bëjë ndryshimet përkatëse me nr. rendor _____, në kolonën _____ duke ndarë regjistrimet me bojë të kuqe.

Tiranë, më 4.10. 2004

GIJOTARE



Majlinda Dogga
Majlinda Dogga

VENDIM

I GJYQARIT TË VETËM



Sot, më datë 28.12. 2004, unë gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Znj. Majlinda Dogga, pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Raiffeisen Bank Sh.A., Z. Steven Grunerud, si dhe dokumentet e tjera bashkëngjitur kërkesës,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria "Raiffeisen Bank" Sh.A. është krijuar si person juridik në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë më datë 11 dhjetor 1992 në përputhje me ligjin nr. 7560, datë 28 prill 1992 "Për Sistemin Bankar në Republikën e Shqipërisë", dhe është regjistruar si shoqëri anonime në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 17426, datë 10 Korrik 1997. Me vendime te ndryshme janë bërë ndryshime në aktet e depozituara pranë regjistrit tregtar.


Më datë 17 nëntor 2004 është mbajtur mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionarit të Vetëm të Raiffeisen Bank Sh.A. në të cilën, ndër të tjera, u vendos:

1. Të miratojë Statutin e ri të Bankës Raiffeisen Bank Sh.A sipas materialit të bashkëngjitur këtij Vendimi si Shtojca 1, e cila përbën pjesë të pandashme të këtij Vendimi.
2. Statuti i mëparshëm i Bankës Raiffeisen Bank Sh.A shfuqizohet.
3. Të autorizojë Z. Steven Grunerud të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme dhe/ose procedurat lidhur me zbatimin e vendimeve të mësipërme si dhe të depozitojë këtë akt së bashku me shtojcat e tij në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Meqënëse janë paraqitur të gjitha dokumentat e nevojshme dhe meqënëse unë i gjej ato plotësisht në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 28.01.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7632, datë 04.11.1992 "Për Dispozitat që Rregullojnë Pjesën e Parë të Kodit Tregtar",

VENDOSA:



Pranimin e kërkesës.

Depozitim në Regjistrin Tregtar, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, të Vendimit Asamblesë së Jashtëzakonshme të Raiffeisen Bank Sh.A., me datë 17.11.2004 ku u vendos:

1. Të miratojë Statutin e ri të Bankës Raiffeisen Bank Sh.A sipas materialit të bashkëngjitur këtij Vendimi si Shtojca 1, e cila përbën pjesë të pandashme të këtij Vendimi.
 2. Statuti i mëparshëm i Bankës Raiffeisen Bank Sh.A shfuqizohet.
- Urdhërimin e zyrës së Regjistrit Tregtar të bëjë ndryshimet përkatëse me nr. rendor _____, në kolonën _____ duke ndarë regjistrimet me bojë të kuqe.

Tiranë, më 26.12. 2004



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR 2778 REP

VERTETIM

Sot ne daten 09.05.2006(dymije e gjashte) perpara meje Noteres MIMOZA SADUSHAJ, Notere prane Dhomes se Noterise Tirane me adrese Rr. " Vaso Pasha" P. 13, u paraqit personalisht Z. EDLIRA CEPANI,e bija e Clirimit,lindur me 08.04.1981 ne Meksike dhe banuese ne Tirane, madhore me zotesi juridike per te vepruar,e njohur prej meje personalisht , e cila me paraqiti originalin e nje vendimi te gjyqatarit te vetem nr 17426/7 date 1.10.2004 te " Raiffeisen Bank" sh.a. dhe une noterja vertetoj se fotokopja eshte e njejte me originalin.



NOTERE

MIMOZA SADUSHAJ

URDHER REGJISTRIMI

I	Nr. regjistrimi	35733
II	A. Emri	" Raiffeisen - Leasing " SH.A
	B. Selia	Dr. Laryes Cirane
	C. Objekti	urkitim i repartit te p. rene financiare, Group e rekrute me pelleve te rishites e tyre, kredisellime te futurime te repartit te p. rene d. Raiffeisen - Leasing Superstionale Gesellschafft mb.H.
	D. Kapitali	123 000 000 lekë: " Raiffeisen Bank, SH.A. 75% d. Raiffeisen - Leasing Superstionale Gesellschafft mb.H. 25%
III	Administratori	Majlinda Hakau SH. 11067 Cirane, Dr. M. Larye p. 56 / 1 / 7. Cirane
IV	Kohezgjatja	KM: 1 - Ziker Schiedl d. Stefan Grunert 3 - Robert Kirjatz
	Akt - Themelimi	5 fletë
	Statuti	12 fletë EUA: KPMG
V	Nenshkrimi	
	Statuti	28.04.06 15.05.06
	Akt - Themelimi	

Verifikim i Raiffeisen Bank
dt. 27.04.06

GJYQTARE

MARIANA DEDI

Prokuror Nr. 2538/PPS dt. 18.04.06

D. Regjistrimi Nr. 6887/1 dt. 23.04.06

EUA me rekrute te p. rene te dt. 24.02.06
me qe e grupit investim e tyne d
me e grupit investim.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
NR. ___ REP. 2576
NR. ___ KOL. 996



AKT THEMELIM
I
SHOQËRISË ANONIME "RAIFFEISEN LEASING" sh.a.

Sot, më datë 28.09.2006 në Tiranë, përpara meje Noteres Znj. **Mimoza Sadushi**, Notere e Dhomës së Noterëve, Tiranë, u paraqitën përfaqësuesit e palëve të mëposhtme:

Raiffeisen Bank sh.a., një bankë e themeluar dhe që është organizuar, në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën Rruga Kavajes, Tirana, Shqipëri, përfaqësuar nga **Z. Steven Grunerud**, në cilësinë e tij si përfaqësues ligjor (më poshtë referuar si, "RBAL"); dhe

Raiffeisen - Leasing International Gesellschaft m.b.H., një shoqëri e themeluar dhe që është organizuar, në bazë të ligjeve të Austrisë, me seli në Am Stadtpark 9, 1030 Vienë, Austri, përfaqësuar nga Znj. **Rudina Ziu**, në cilësinë e saj si përfaqësuese ligjore (këtu e më poshtë referuar si "RLI").

Unë, Noteri, pasi studiova dokumentacionin e paraqitur nga palët dhe/ose përfaqësuesit e tyre, vërtetoj se përfaqësuesit e palëve të mësipërme janë madhorë me zotësi të plotë për të vepruar dhe se palët e mësipërme janë krijuar dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre rregullisht. Me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, palët kanë kërkuar të hartohet Akti I Themelimit si më poshtë vijon në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe kanë rënë dakort me tekstin e këtij dokumenti sipas kushteve dhe termave të mëposhtëm.

I. Dispozita të Përgjithshme

- § 1. Emërtimi i Shoqërisë është "Raiffeisen-Leasing" sh.a." (më poshtë referuar si "Shoqëria").
- § 2. Selia e Shoqërisë është në: Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri.
- § 3. Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar.
- § 4. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Asambleja e Aksionareve mund të krijojë ose të mbyllë dege dhe/ ose filiale në Shqipëri dhe jashtë saj.
- § 5. Aksionerët themelues të Shoqërisë janë:
- a) **Raiffeisen Bank sh.a.**, Tirana, Albania;
 - b) **Raiffeisen - Leasing International Gesellschaft m.b.H.**, Vienë, Austri;

II. Objekti i Shoqërisë

§ 6. 1. Objekti i Shoqërisë është:

- a) ushtrimi I veprimtarisë së qirasë financiare, qiradhënia financiare e sendeve të luajshme dhe pasurive të paluajshme, dhe
- b) blerja e sendeve me qëllim rishitjen e tyre, dhe
- c) financimi ose kredidhënia në funksion të veprimtarisë së qirasë financiare, dhe
- d) Të gjitha veprimtaritë e tjera të biznesit të lidhura apo plotësuese, të cilat mund të jenë të nevojshme (duke përfshirë ndër të tjera, shërbime regjistrimi, ndërmjetësim në sigurime, menaxhim ndërtimesh dhe të infrastrukturave që lidhen me to për pasuri të paluajshme ose kryerja e shërbimeve të tjera që lidhen me objektet e dhëna në qira financiare).

2. Nëse Shoqëria angazhohet në një aktivitet i cili kërkon një leje, miratim apo licensë, Drejtoria duhet të aplikojë për certifikimin përkatës.

§ 7. Shoqëria ka të drejtën të themelojë filiale ose dege brenda vendit dhe të blejë pjesëmarrje në çfarëdolloj mënyre ligjore në shoqëri të tjera tregtare, si dhe të realizojë projekte tregtare së bashku me subjekte të tjera tregtare.

III. Kapitali aksionar dhe aksionet

§ 8. 1. Kapitali I Shoqërisë është 123 000 000 ALL (Lekë Shqiptare) (njëqind e njëzetetë milionë lekë) ose 1 000 0000 Euro (një milionë Euro) dhe ndahet në 1000 (njëmijë) aksione me vlerë nominale prej 123 000 ALL (njëqind e njëzet e tre mijë lekë) secila ose 1 000 Euro (njëmijë Euro) secila. Cdo aksion është I pandashëm dhe përbën të drejtën e një vote.

2. Secili prej aksionarëve mund të zotërojë më shumë se një aksion.

3. Ndarja e aksioneve midis aksionarëve është si më poshtë:

- a) **RBAL: 750** aksione (shtatëqind e pesëdhjetë) me vlerë nominale 92 250 000 ALL (nëntëdhjetë e dy milionë dyqind pesëdhjetë mijë lekë) ose 750 000 Euro (shtatëqind pesëdhjetë mijë).
- b) **RLI: 250** aksione (dyqind e pesëdhjetë) me vlerë nominale 30 750 000 ALL (tridhjetëmilionë shtatëqind e pesëdhjetë mijë Lekë) ose 250 000 Euro (dyqind pesëdhjetë mijë).

§ 9. Aksionet mund të transferohen në përputhje me ligjet ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara në Statut.

IV. Organet e Shoqërisë

§ 10. 1. Shoqëria përbëhet nga organet e mëposhtme:

- a) Asambleja e Aksionarëve;
- b) Këshilli Mbikqyrës;

c) Drejtoria.

2. Kompetencat, funksionimi dhe organizimi i organeve te Shoqerise rregullohet ne Statutin e saj.

Asambleja e Aksionarëve

Asambleja e Aksionarëve mund të jetë e zakonshme dhe e jashtëzakonshme dhe thirret në mbledhje nga Këshilli Mbikqyrës ose nga Drejtoria, ose sipas parashikimeve ligjore ne fuqi.

Këshilli Mbikqyrës

§ 12. 1. Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 3 (tre) deri në 12 (dymbëdhjetë) anëtarë. 2/3 (dy të tretat) e anëtarëve zgjidhen nga Asambleja e Aksionarëve. 1/3 (një e treta) e anëtarëve të tij zgjidhet nga punonjësit e shoqërisë, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Anëtarët e Këshillit të parë Mbikqyrës emërohen nga Asambleja e Aksionarëve. Kohëzgjatja e mandatit të tyre është 3 (tre) vjet nga dita e emërimit në detyrë.

2. Anëtarët e Këshillit të parë Mbikqyrës janë zgjedhur personat e mëposhtëm kohëzgjatja e mandatit të të cilëve në këtë detyrë është 3 (tre) vjet:

1. **Z. Dieter Schiedl**, shtetas austriak, lindur në Gmuend, Austri, më 11.09.1967, banues në Huglgasse 11/7, 1150 Vienë, Austri, me pas. N. A 0087535;
2. **Z. Steven Grunerud**, shtetas kanadez, lindur në Vankuver, Kanada, më 03.04.1963, banues në Tiranë, Shqipëri, me pas. N. BC16338;
3. **Z. Robert Wright**, shtetas anglez, lindur në Birkenhead, Angli, më 25.10.1956, banues në Tiranë, Shqipëri, me pas. N. 093121379.

VII. Drejtoria

§ 13. 1. Drejtoria përbëhet nga nje ose më shumë anëtarë, të cilët emërohen nga Këshilli Mbikqyrës për një mandat jo më të gjatë se katër vjet; rizgjedhja është e lejueshme. Anëtarët e Drejtorisë mund të shkarkohen nga funksioni i tyre prej Këshillit Mbikqyrës. Këshilli Mbikqyrës emëron Kryetarin e Drejtorisë dhe gjithashtu, një zv. Kryetar nga anëtarët e emëruar.

2. Shoqëria do të përfaqësohet ligjërisht tek të tretët nga Kryetari i Drejtorisë, ose në mungesë të tij nga Zv. Kryetari i Drejtorisë. Në rast se Drejtoria përbëhet nga një Drejtor, ky i fundit do të ketë të drejtën e përfaqësimit të Shoqërisë tek të tretët.

3. Për transaksionet financiare në lidhje me veprimtarinë e qirasë financiare Shoqëria do të përfaqësohet bashkarisht nga një anëtar i Drejtorisë dhe një nëpunës i autorizuar për të nënshkruar në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Rregullat në lidhje me të drejtën e nënshkrimit në emër dhe për llogari të Shoqërisë do të përcaktohen nga Këshilli Mbikqyrës.

4. Drejtoria e parë e Shoqërisë përbëhet nga një Drejtor, kohëzgjatja e mandatit të të cilit është 4 (katër) vjet.

5. **Znj. Majlinda Hakani**, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 27.05.1967, banuese në Tiranë, në adresën Rr. Muhamet Gjollësia, Pall. 56/1/7, pas. N. 0777898; është emëruar Drejtore e Shoqërisë dhe për sa kohë që Drejtoria e Shoqërisë do të përbëhet nga një Drejtor, **Znj. Hakani** do të ketë të gjitha kompetencat dhe do të kryejë të gjitha detyrat që Statuti i Shoqërisë ka parashikuar për Drejtorinë, Kryetarin dhe Zv. Kryetarin e Drejtorisë.

6. **Znj. Hakani** nëpërmjet këtij akti ngarkohet të kryejë të gjithë procedurat e nevojshme për rregjistrimin e Shoqërisë si person juridik në Rregjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë; dhe për rregjistrimin e saj në organet perkatese fiskale. Ajo autorizohet të përfaqësojë Shoqërinë përpara të gjithë organeve gjyqësore, personave fizike dhe/ose personave juridike dhe/ose institucioneve publike për përmbushjen e detyrave të ngarkuara me siper dhe të nënshkruajë aktet e nevojshme në lidhje me to. **Znj. Hakani** ka të drejtë të emerojë avokate nëpërmjet një prokure noteriale duke i autorizuar ata të kryejnë veprimet e nevojshme për përmbushjen e detyrave ngarkuar asaj nëpërmjet këtij akti.

VIII. Kontrollorët

- § 14. Kontrolli i brendshëm i Shoqërisë kryhet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të emëruar për një vit ushtrimor.
- § 15. Kontrollorë e Shoqërisë është zgjedhur shoqëria e të drejtës shqiptare **KPMG Albania sh.p.k.**

IX. Likuidimi dhe Mbyllja

- § 16. Shoqëria konsiderohet e mbyllur në rast se vërtetohen faktet e parashikuara nga ligji. Në rast mbyllje, Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionarëve zgjedh një ose më shumë likuidatorë dhe u jep atyre kompetencat përkatëse.
- § 17. Shoqëria mund gjithashtu të shpërndalet apo të bashkohet me një tjetër me vendim të Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Aksionerëve.
- § 18. Ky Akt Themelimi është hartuar dhe rregullohet sipas legjislacionit shqiptar.
- § 19. Të gjitha kontradiktat që lindin ose që lidhen me interpretimin i këtij Akti Themelimi, ndërmjet Aksionarëve ose midis një ose më shumë Aksionarëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe të drejtpërdrejtë midis palëve.
- § 20. Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin për ose në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin, shkeljen, përfundimin ose pavlefshmërinë e këtij Akti Themelimi midis aksionarëve, një aksionari dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në bazë të Rregullave të Arbitrazhit dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të Qendrës së Arbitrazhit të Dhomës Federale Ekonomike Austriake, Vienë, prej tre arbitrave të emëruar në bazë të këtyre rregullave. Vendi i arbitrazhit do të jetë Viena, Austri dhe gjuha që do përdoret në procesin e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze.

X. Dispozita Përfundimtare

§ 21. Ky Akt Themelimi përpilohet në 10 (dhjetë) kopje, 5 (pesë) prej të cilave janë në Anglisht dhe 5 (pesë) në Shqip. Në rast të ndonjë konflikti midis versioneve në gjuhë Angleze dhe Shqipe, versioni në Anglisht do të jetë mbizotërues.

§ 22. Në lidhje me çështjet që nuk janë rregulluar në këtë Akt Themelimi, do të zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

* * * * *

Unë Noteri pasi lexova këtë Akt Themelimi me zë të lartë Palëve të pranishme, jam e bindur se palët e gjejnë atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë dhe e firmosin lirisht para meje, dhe unë Noteri e vërtetoj atë sipas ligjit.

AKSIONARËT

Raiffeisen Bank sh.a.

Raiffeisen - Leasing International Gesellschaft m.b.H.

Z. Steven Grunerud


Znj. Rudina Ziu

Steven Grunerud

Rudina Ziu

NOTERE

Znj. Mimoza Sadushi



PERKTHYES

Znj. Edlira Cepani

Edlira Cepani

Edlira Cepani

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
NR. ___ REP. 2537
NR. ___ KOL. 997



STATUTI
I
SHOQËRISË ANONIME "RAIFFEISEN LEASING" sh.a.

Sot, më datë 28.09.2006 në Tiranë, përpara meje Noteres Znj. **Mimoza Sadushi**, Notere e Dhomës së Noterëve, Tiranë, u paraqitën përfaqësuesit e palëve të mëposhtme:

Raiffeisen Bank sh.a., një bankë e themeluar dhe që është organizuar, në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën Rruga Kavajes, Tirana, Shqipëri, përfaqësuar nga **Z. Steven Grunerud**, në cilësinë e tij si përfaqësues ligjor (më poshtë referuar si, "RBAL"); dhe

Raiffeisen - Leasing International Gesellschaft m.b.H, një shoqëri e themeluar dhe që është organizuar, në bazë të ligjeve të Austrisë, me seli në Am Stadtpark 9, 1030 Vienë, Austri, përfaqësuar nga Znj. **Rudina Ziu**, në cilësinë e saj si përfaqësuese ligjore (këtu e më poshtë referuar si "RLI").

Unë, Noteri, pasi studiova dokumentacionin e paraqitur nga palët dhe/ose përfaqësuesit e tyre, vërtetoj se përfaqësuesit e palëve të mësipërme janë madhorë me zotësi të plotë për të vepruar dhe se palët e mësipërme janë krijuar dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre rregullisht. Me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, palët kanë kërkuar të hartohet Statuti si më poshtë vijon në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe kanë rënë dakort me tekstin e këtij dokumenti sipas kushteve dhe termave të mëposhtëm.

I. Dispozita të Përgjithshme

- § 1. Emërtimi i Shoqërisë është "Raiffeisen-Leasing" sh.a." (më poshtë referuar si "Shoqëria").
- § 2. Selia e Shoqërisë është në: Rruga e Kavajës, Tiranë, Shqipëri.
- § 3. Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar.
- § 4. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Asambleja e Aksionareve mund të krijojë ose të mbyllë filiale dhe/ose dege në Shqipëri dhe jashtë saj.
- § 5. Aksionerët themelues të Shoqërisë janë:
- a) **Raiffeisen Bank sh.a.**, Tirana, Albania;
 - b) **Raiffeisen - Leasing International Gesellschaft m.b.H**, Vienë, Austri;
- § 6. Përsa i përket marrëdhënieve ndërmjet Shoqërisë dhe aksionerëve, vendbanimi i secilit prej aksionerëve është ai që është vendosur në regjistrin e aksioneve.

II. Objekti i Shoqërisë

§ 7. 1. Objekti i Shoqërisë është:

- a) ushtrimi I veprimtarisë së qirasë financiare, qiradhënia financiare e sendeve të luajtshme dhe pasurive të paluajtshme, dhe
- b) blerja e sendeve me qëllim rishitjen e tyre, dhe
- c) financimi ose kredidhënia në funksion të veprimtarisë së qirasë financiare, dhe
- d) Të gjitha veprimtaritë e tjera të biznesit të lidhura apo plotësuese, të cilat mund të jenë të nevojshme (duke përfshirë ndër të tjera, shërbime regjistrimi, ndërmjetësim në sigurime, menaxhim ndërtimelesh dhe të infrastrukturave që lidhen me to për pasuri të paluajtshme ose kryerja e shërbimeve të tjera që lidhen me objektet e dhëna në qira financiare).

2. Nëse Shoqëria angazhohet në një aktivitet i cili kërkon një leje, miratim apo licensë, Drejtoria duhet të aplikojë për certifikimin përkatës.

§ 8. Shoqëria ka të drejtën të themelojë filiale ose dege brenda vendit dhe të blejë pjesëmarrje në çfarëdolloj mënyre ligjore në shoqeri të tjera tregtare, si dhe të realizojë projekte tregtare së bashku me subjekte të tjera tregtare.

III. Kapitali aksionar dhe aksionet

§ 9. 1. Kapitali I Shoqërisë është 123 000 000 ALL (Lekë Shqiptare) (njëqind e njëzetetrec milionë lekë) ose 1 000 0000 Euro (një milionë Euro) dhe ndahet në 1000 (njëmijë) aksione me vlerë nominale prej 123 000 ALL (njëqind e njëzet e tre mijë lekë) secila ose 1 000 Euro (njëmijë Euro) secila. Cdo aksion është I pandashëm dhe përbën të drejtën e një vote.

2. Secili prej aksionarëve mund të zotërojë më shumë se një aksion.


3. Ndarja e aksioneve midis aksionarëve është si më poshtë:

a) **RBAL: 750** aksione (shtatëqind e pesëdhjetë) me vlerë nominale 92 250 000 ALL (nëntëdhjetë e dy milionë dyqind pesëdhjetë mijë lekë) ose 750 000 Euro (shtatëqind pesëdhjetë mijë).

b) **RLI: 250** aksione (dyqind e pesëdhjetë) me vlerë nominale 30 750 000 ALL (tridhjetëmilionë shtatëqind e pesëdhjetë mijë Lekë) ose 250 000 Euro (dyqind pesëdhjetë mijë).

§ 10 1. Aksionet mund të transferohen në përputhje me ligjet dhe dispozitat e parashikuara në Statut.

2. Shoqëria duhet të mbajë një regjistër aksionesh në të cilin të figurojnë emri dhe mbiemri, ose emri i Shoqërisë, si dhe adresa e zotëruesit të një aksioni të regjistruar, shumta e pagesave të kryera për aksion, gjithashtu edhe njoftimet në lidhje me transferimin e këtij aksioni kundrejt palëve të treta, duhet të regjistrohen së bashku me datën e hyrjes.

- 
3. Çdo transferim i aksioneve të Shoqërisë duhet t'i nënshtrohet miratimit të aksionarëve. Transferimi *inter vivos* i aksioneve të Shoqërisë është objekt i të drejtës së parablerjes në favor të aksionarëve të tjerë, të cilët mund ta ushtrojnë këtë të drejtë brenda 20 ditëve nga data e letrës së dërguar me postë rekomande, e cila përmban ofertën përkatëse. Dispozitat e këtij Neni nuk zbatohen në lidhje me shitjet dhe transferimet e kryera ndërmjet aksionarëve. Sidoqoftë, në këtë rast, transferimi duhet t'i komunikohet paraprakisht me shkrim aksionarëve të tjerë. Të gjitha njoftimet e parashikuara në këtë Nen, duhet t'i dërgohen gjithashtu edhe Shoqërisë.
 4. Në rast të rritjes së kapitalit të Shoqërisë, aksionet e reja i ofrohen si opion aksionarëve të saj në proporcion me numrin e aksioneve që ata zotërojnë, për tu nënshkruar dhe paguar në bazë të ligjit.
 5. Forma dhe përmbajtja e certifikatave të aksioneve (ose certifikatave të përkohshme të aksioneve) duhet të përcaktohet me vendim të Drejtorisë në përputhje me ligjet në fuqi.
 6. Drejtoria mund të urdhërojë emetimin/lëshimin e një certifikate të re, në vend të cilësdo certifikatë të emtuar deri atëherë nga Shoqëria, e cila supozohet të ketë humbur ose të jetë shkatërruar. Kur autorizon emetimin e kësaj certifikate të re, përpara se ta emetojë atë, Drejtoria ka të drejtë të përcaktojë kushte dhe terma që i konsideron të arsyeshme, si dhe mund të kërkojë dëmshpërblime përkatëse nëse gjykon se janë të përshtashme për të mbrojtur Shoqërinë nga çdo deklaram që mund të jetë kundër saj, në lidhje me cilëndo prej këtyre certifikatave të cilat supozohet se kanë humbur ose janë shkatërruar.

IV. Organet e Shoqërisë

§ 11. Shoqëria përbëhet nga organet e mëposhtme:

- a) Asambleja e Aksionarëve;
- b) Këshilli Mbikqyrës;
- c) Drejtoria.

V. Asambleja e Aksionarëve

§ 12. Asambleja e Aksionarëve mund të jetë e zakonshme dhe e jashtëzakonshme dhe thirret në mbledhje nga Këshilli Mbikqyrës ose nga Drejtoria, ose sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

§ 13. Asambleja e Aksionarëve zhvillohet të paktën një herë në vit, si Asamble e zakonshme, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar.

§ 14. 1. Asambleja e Aksionarëve, duhet të thirret në mbledhje me anë të njoftimit dërguar me postë rekomande. Kjo letër duhet t'i dërgohet Aksionarëve në adresat që i kanë komunikuar Shoqërisë, të paktën dy javë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë. Njoftimi përmban datën, kohën dhe vendin e Mbledhjes së Aksionarëve, si dhe rendin e ditës të detajuar. Mbledhjet e Asamblesë zhvillohen në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër të përcaktuar në njoftim.

2. Mbledhja e Asamblesë është e vlefshme edhe nëse të gjithë aksionarët e Shoqërisë janë të pranishëm në Asamblesë e Aksionarëve dhe nëse asnjëri prej aksionarëve nuk ka

kundërshtime në lidhje me zhvillimin e Asamblesë ose në lidhje me përfshirjen e disa çështjeve në rendin e ditës.

§ 15. Vendimet e aksionarëve merren në Asamble. Nëse të gjithë aksionarët shprehin miratimin e tyre me shkrim në lidhje me vendimin që duhet të merret ose me votimin (duke përfshirë këtu nëpërmjet faksit, teleks-it dhe telegramit), vendimet mund të merren pa zhvilluar një mbledhje. Nëse këto kushte ekzistojnë, Asambleja e Aksionarëve zhvillohet në një vend në të cilin ndodhet si Presidenti, ashtu edhe Sekretari i mbledhjes, në mënyrë që të kryhet përpilimi dhe nënshkrimi i procesverbaleve të mbledhjes në regjistrin përkatës.

§ 16. 1. Vendimet e Asamblesë së Zakonshme të Aksionarëve janë të vlefshme kur 75% e aksionarëve me të drejtë vote janë të pranishëm personalisht ose të përfaqësuar me prokurë. Në rast se ky quorum nuk është i pranishëm, mbledhja me të njëjtin rend dite do të njoftohet për tu mbajtur jo më vonë se 2 (dy) muaj nga data e mbledhjes së parë. Asambleja e azhornuar do të marrë vendime me çfarëdolloj quorumi të pranishëm. Asambleja e azhornuar thirret në mbledhje në të njëjtën mënyrë sic është thirrur Asambleja e Zakonshme e Aksionarëve herën e parë. Vendimet e Asamblesë së Zakonshme të Aksionarëve merren me shumicën e votave që zotërojnë aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar.

2. Vendimet e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionarëve, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ose të përfaqësuar me prokurë 75 % e aksionarëve me të drejtë vote. Në rast se ky quorum nuk është i pranishëm, mbledhja me të njëjtin rend dite do të njoftohet për tu mbajtur jo më vonë se 2 (dy) muaj nga data e mbledhjes së parë. Asambleja e azhornuar do të marrë vendime kur është i pranishëm një quorum prej 25% e aksionarëve më të drejtë vote. Asambleja e azhornuar thirret në mbledhje në të njëjtën mënyrë sic është thirrur Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionarëve herën e parë. Vendimet e Asamblesë së Jashtëzakonshme merren me një shumicë votash prej $\frac{3}{4}$ që zotërojnë aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar.

§ 17. E drejta e votës në Asamblenë e Përgjithshme varet nga vlera e secilës prej aksioneve. Cdo aksion me një vlerë prej 123 000 Leke (*njëqind njëzet e tre mijë*) ose 1000 Euro (*njëmijë*) jep të drejtën e një vote.

§ 18. Aksionerët mund të ushtrojnë të drejtat e tyre të votës në Asamblenë e Aksionarëve me anë të pranishëm të tyre personale ose të përfaqësimit me prokurë. Prokura duhet të depozitohet në shoqëri përpara fillimit të Asamblesë dhe do të jetë e vlefshme për atë Asamble, si dhe për Asamblenë e azhornuar, në rast të mungesës së quorumit të aksionarëve të pranishëm në Asamblenë e parë.

§ 19. Përveç kompetencave të tjera që legjislacioni në fuqi parashikon për Asamblenë e Aksionarëve, kjo e fundit do të ketë kompetenca ekskluzive në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- a) ndryshimin ose plotësimin e këtij Satuti, duke përfshirë edhe ndryshimet në lidhje me objektin e Shoqërisë;
- b) rritjen ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë;
- c) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës dhe dhënien e huave, bonove ose benefiteve të tjera anëtarëve;
- d) dëmshpërblime në favor të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës;

- e) emërimi i likuidatorëve;
- f) vendime në lidhje me riblerjen e aksioneve dhe vendosjen e rregullave bazë për këtë;
- g) vendosja e kushteve dhe termave për pagesën e detyrimeve të saj ndaj të tretëve (obligacioneve) ose instrumentave të tjera të borxhit;
- h) marrja e vendimeve në lidhje me çështje të tjera, nëse kërkohet nga dispozita të vecanta;
- l) miratimi i bilancit vjetor dhe marrja e vendimeve mbi shpërndarjen e fitimit vjetor, si dhe mbulimin e humbjeve;
- k) emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të Shoqërisë;
- m) marrjen e vendimeve mbi shkrijen, shndërrimin ose likuidimin e Shoqërisë.

§ 20 1. Kryetari i Asamblesë së Aksionarëve është përfaqësuesi ligjor i aksionarit të shumicës. Asambleja e Aksionarëve zgjedh një Sekretar për mbledhjen, i cili mund edhe të mos jetë aksionar.

2. Kryetari i Asamblesë së Aksionarëve drejton mbledhjen e Asamblesë së Aksionarëve. Ai nuk është i autorizuar të heqë ose të ndryshojë çështje nga rendi i ditës me diskrecionin e tij.

3. Procesverbalet e Asamblesë së Aksionarëve dhe vendimet përkatëse mbahen nga sekretari dhe nënshkruhen nga ai/ajo dhe nga Kryetari i Asamblesë së Aksionarëve. Procesverbalet mbahen në një regjistër të veçantë. Vendimet e Asamblesë së Aksionarëve duhet të mbahen në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Në rast të një konflikti ndërmjet versioneve në gjuhën Angleze dhe Shqipe, do të ketë përparësi versioni në gjuhën angleze.

§ 21. Anëtarët e Drejtorisë dhe të Këshillit Mbikqyrës marrin pjesë në Asamblenë e Aksionarëve në përmbushje të detyrave të tyre. Ekspertët Kontabël të Shoqërisë ftohen të marrin pjesë nëse prezenca e tyre është e nevojshme sipas rendit të ditës. Mungesa e të gjithë ose e disa anëtarëve të Drejtorisë, të Këshillit Mbikqyrës ose të eksperteve kontabël nuk e çënon vlefshmërinë e Asamblesë së Aksionarëve.

VI. Këshilli Mbikqyrës

§ 22.1. Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 3 (tre) deri në 12 (dymbëdhjetë) anëtarë. 2/3 (dy të tretat) e anëtarëve zgjidhen nga Asambleja e Aksionarëve. 1/3 (një e treta) e anëtarëve të tij zgjidhet nga punonjësit e shoqërisë, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Anëtarët e Këshillit të parë Mbikqyrës emërohen nga Asambleja e Aksionarëve. Kohëzgjatja e mandatit të tyre është 3 (tre) vjet nga dita e emërimit në detyrë.

2. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës emërohet për një kohë jo më të gjatë se tre vjet; Riemërimi në këtë detyrë është i lejueshëm. Kryetari dhe Zv.Kryetari i Këshillit Mbikqyrës emërohen nga Këshilli Mbikqyrës, ndër anëtarët e tij me një shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të këtij organi. Ata zgjidhen për të gjithë kohëzgjatjen e mandatit të tyre dhe në përfundim të tij kanë të drejtë të rizgjidhen.

3. Anëtarët e Këshillit të parë Mbikqyrës janë zgjedhur personat e mëposhtëm kohëzgjatja e mandatit të të cilëve në këtë detyrë është 3 (tre) vjet:

1. **Z. Dieter Schiedl**, shtetas austriak, lindur në Gmuend, Austri, më 11.09.1967, banues në Huglgasse 11/7, 1150 Vienë, Austri, me pas. N. A 0087535;
2. **Z. Steven Grunerud**, shtetas kanadez, lindur në Vankuver, Kanada, më 03.04.1963, banues në Tiranë, Shqipëri, me pas. N. BC16338;
3. **Z. Robert Wright**, shtetas anglez, lindur në Birkenhead, Angli, më 25.10.1956, banues në Tiranë, Shqipëri, me pas. N. 093121379.

§ 23. 1. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të zgjedhur nga Asambleja e Aksionarëve, mund të shkarkohen për çfarëdolloj arsyeje nga vetë Asambleja e Aksionarëve. Anëtarët e zgjedhur nga punonjësit mund të shkarkohen sipas ligjit.

2. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës kanë të drejtë të japin dorëheqjen në çdo moment, pa qënë nevoja të deklarojnë arsyet e kësaj dorëheqjeje. Deklarata e dorëheqjes duhet t'i jepet Kryetarit të Këshillit Mbikqyrës, ose në mungesë të tij, Zv.Kryetarit.

3. Në rast vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqjeje, anëtari duhet të zëvendësohet, brenda jo më shume se 3 (tre) muajve. Anëtari i Këshillit Mbikqyrës, i zgjedhur për të zëvendësuar një tjetër anëtar, do të qendrojë në detyrë përgjatë gjithë kohës së mbetur të mandatit të paraardhësit.

§ 24. 1. Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës thirren nga Kryetari i tij, ose në mungesë të tij, nga Zv.Kryetari, të paktën 3 (tre) herë në vit. Mbledhje të tjera të Këshillit mund të thirren sipas kërkesës të cilido prej anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës ose të Drejtorisë, duke specifikuar qëllimin e kësaj kërkesë.

2. Të gjitha mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës duhet të thirren dhe të njoftohen me postë rekomande ose me faks, duke specifikuar rendin e ditës. Njoftimi duhet të kryhet jo më vonë se dy javë përpara datës përkatëse të mbledhjes. Në raste urgjente, periudha e njoftimit për mbledhjen mund të jetë më pak se dy javë.

3. Vendimet e Këshillit Mbikqyrës mund të merren me shkrim edhe nepermjet faksit, telex-it, telegramit, postës elektronike dhe mjeteve të tjera të komunikimit, nëse të gjithë anëtarët e Këshillit Mbikqyrës kanë deklaruar me shkrim miratimin e tyre për këtë mënyrë vendimmarrjeje. Nëse ekzistojnë këto kushte, Këshilli Mbikqyrës konsiderohet se mbledhet në vendin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes, në mënyrë që të kryhet përpilimi dhe nënshkrimi i procesverbalit në regjistrin përkatës.

4. Mbledhja e Këshillit Mbikqyrës zhvillohet në vendin ku ndodhet selia e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të përcaktuar në njoftim. Procesverbalet mbahen nga një sekretar i zgjedhur nga Këshilli për secilën mbledhje, dhe nënshkruhen nga ajo/ai dhe nga Kryetari i Këshillit Mbikqyrës. Sekretari mund të jetë edhe një person që nuk është anëtar i Këshillit. Procesverbalet mbahen në një regjistër të veçantë. Procesverbalet përpilohen në Anglisht dhe në Shqip. Në rast të një konflikti ndërmjet versioneve në gjuhën Angleze dhe Shqipe, do të ketë përparësi versioni në Anglisht. Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës do të zhvillohen në Anglisht.

§ 25. Këshilli Mbikqyrës nuk mund të marrë vendime të vlefshme nëse nuk janë të pranishëm të paktën ½ e anëtarëve të tij. Vendimet e Këshillit Mbikqyrës duhet të merren me unanimitet nga anëtarët e Këshillit Mbikqyrës që marrin pjesë në votim. Në rast të numrit të votave të barabarta, vota e Kryetarit është vendimtare.

§ 26. 1. Këshilli Mbikqyrës emëron, pezullon ose shkarkon anëtarët e Drejtorisë dhe lidh ose përfundon kontratat e punës, si dhe, nëse aplikohet, lidh ose përfundon kontrata pensioni me anëtarët e Drejtorisë.

2. Këshilli Mbikqyrës ka të drejtën të vendosë mbi çdo çështje që lidhet me marrëdhëniet ndërmjet një anëtari të Drejtorisë dhe Shoqërisë, duke përfshirë, por duke u kufizuar jo vetëm në, përcaktimin e autoritetit të tyre, zgjatjen e kredisë së dhënë nga Shoqëria, dorëheqjen, daljen në pension etj, me përjashtim të shkarkimit ose heqjes dorë nga detyrimi.

§ 27. Këshilli Mbikqyrës kontrollon të gjitha aktivitetet e Shoqërisë. Kontrollon zbatimin e Statutit dhe të çdo dispozite përkatëse ligjore në lidhje me organet e Shoqërisë. Këshilli Mbikqyrës ka të drejtën të inspektojë llogaritë e Shoqërisë, librin e llogarive, regjistrat dhe të gjithë administrimin e saj. Këshilli Mbikqyrës duhet të kontrollojë dhe të verifikojë bilancet vjetore dhe përputhjen e tyre me llogaritë e Shoqërisë dhe regjistrat përkatës, si dhe me gjendjen aktuale; gjithashtu do të kontrollojë dhe verifikojë raportet e biznesit, si dhe propozimet e Drejtorisë dhe do të japë vërejtjet e tij mbi bilancin vjetore, raportet e biznesit dhe propozimet e Asamblesë së Aksionarëve.

§ 28. Këshilli Mbikqyrës duhet të miratojë rregullat e tij të brendshme, të cilat duhet të specifikojnë mënyrën e përmbushjes së detyrave të veta dhe zhvillimin e aktiviteteve të tij.

§ 29. Të gjitha deklaratat që do të përpilohen për Këshillin Mbikqyrës ose që do të merren nga ai, do të konsiderohen të vlefshme nëse do të bëhen ose do të merren nga Kryetari i tij, ose në mungesë, nga Zv.Kryetari. Kjo zbatohet në veçanti për deklaratimet që duhet të përpilohen ose të merren *vis-a-vis* nga Drejtoria.

§ 30. Anëtarët e Drejtorisë kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës, por ata nuk kanë të drejtë vote. Sidoqoftë, Kryetari ka të drejtë, të thërrasë një mbledhje të Këshillit Mbikqyrës, pa pjesëmarrjen e njërit ose të gjithë anëtarëve të Drejtorisë.

§ 31. Procesverbalet e Këshillit Mbikqyrës duhet t'i dërgohen aksionarëve, anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, si dhe anëtarëve të Drejtorisë.

§ 32. Këshillit Mbikqyrës duhet të mblidhet menjëherë pas emerimit të tij nga Asambleja e Aksionarëve për të zgjedhur Kryetarit e Këshillit Mbikqyrës. Kjo mbledhje e Këshillit Mbikqyrës zhvillohet pa ndonjë procedurë të veçantë.

VII. Drejtoria

§ 33. 1. Drejtoria përbëhet nga një ose më shumë anëtarë, të cilët emërohen nga Këshilli Mbikqyrës për një mandat jo më të gjatë se katër vjet; rizgjedhja është e lejueshme. Anëtarët e Drejtorisë mund të shkarkohen nga funksioni i tyre prej Këshillit Mbikqyrës. Këshilli Mbikqyrës emëron Kryetarin e Drejtorisë dhe gjithashtu, një zv. Kryetar nga anëtarët e emëruar.

2. Këshilli Mbikqyrës mund të vendosë shpërblim për anëtarët e Drejtorisë në momentin e emerimit të tyre.

3. Në rast të një vendi të lirë për shkak vdekje, dorëheqje, shkarkimi, mos-kualifikimi apo ndonjë shkak tjetër, pasardhësi që do të plotësojë vendin e lirë duhet emëruar nga Këshilli Mbikqyrës në mbledhjen e tij të parë pas krijimit të vendit të lirë. Pasardhësi do të përfundojë mandatin e personit të cilin ai do të zëvendësojë. Nëse shumica e anëtarëve të Drejtorisë japin dorëheqjen, supozohet se e tërë Drejtoria ka dhënë dorëheqjen dhe si pasojë Këshilli Mbikqyrës duhet të procedojë menjëherë për caktimin e Drejtorisë së re.

§ 34. Drejtoria drejton Shoqërinë në pajtim me ligjin, këtë Statut, vendimet e Asamblesë së Aksionerëve dhe vendimet e Këshillit Mbikqyrës. Drejtoria vendos për të gjitha aktivitetet e Shoqërisë, përveçse kur këto aktivitete janë kompetencë e Asamblesë së Aksionarëve ose e Këshillit Mbikqyrës.

§ 35. Drejtoria duhet të marrë miratimin paraprak të Këshillit Mbikqyrës për:

1. vendimet për strategjinë e Shoqërisë, si për shembull vendime mbi:
 - a) strategjinë e përgjithshme të biznesit duke përfshirë vendimet për tregjet, rrugët e shitjeve (degët e RBAL, agjentët e shitjeve, bashkëpunimet me palët shitëse) dhe bashkëpunimet me RBAL në përgjithësi;
 - b) buxhetin strategjik (pesë vjeçar) dhe materialet ndihmëse të Shoqërisë dhe filialeve të saj;
 - c) bashkëpunimin me palë të treta ose shpërndarjen e funksioneve të biznesit të Shoqërisë kundrejt palëve të treta, duke përfshirë dhe krijimin e shoqërive të përbashkëta;
 - d) prezantimi i një produkti të ri (nëpërmjet një rritjeje të konsiderueshme të një produkti ekzistues, por që për shkak të peshës së tij në portofolin e përgjithshëm konsiderohet si prezantim i një produkti të ri);
 - e) buxheti vjetor, duke përfshirë planin vjetor të financimit, planin e investimeve, kufizimet e portofolit dhe materialet mbështetëse të Shoqërisë dhe çfarëdolloj ndryshimi për paralogaritje ose tejkalime të investimeve prej saj;
2. vendime për Drejtorinë e Shoqërisë, për shembull vendime mbi:
 - a) miratimin dhe modifikimin e rregulloreve të Drejtorisë së Shoqërisë;
 - b) dhënien e borxheve, bonove dhe benefiteve të tjera për Drejtorinë e Shoqërisë;
 - c) dhënien dhe anulimin e të drejtave të përfaqësuesve në bazë të një prokure noteriale;
3. vendime të Shoqërisë për manaxhimin e riskut të kredisë, për shembull të:
 - a) autoritetet e miratimit të riskut të kredisë së Shoqërisë (Autoriteti Autonom i Miratimit);
 - b) proceset e miratimit të riskut të kredisë brenda Shoqërisë;
 - c) miratimin e limitit të kredisë për shuma më të larta se ato të Autoritetit Autonom të Miratimit;
 - d) strategjitë e zhvillimit;
4. vendimet mbi riskun e menaxhimit të tregut të shoqërisë p.sh. vendimet mbi:
 - a) miratimet e kufirit të riskut të tregut;
 - b) miratimet për të përdorur instrumentat financiarë të derivuar (të deleguara, opsione, shkëmbime dhe të instrumente të ngjashme);

5. vendimet mbi refinancimin e Shoqërisë p.sh. vendimet mbi;
- a) marrjen e huave dhe mjeteve të tjera financiare të cilat e tejkalojnë planin vjetor të fondeve të miratuara;
 - b) kalimin ose shitjen e të ardhurave prej qirasë financiare për t'u vjelë në të ardhmen (blerjen e borxheve, strukturat ABS) pavarësisht nga shuma.

6. vendimet mbi degët e shoqërisë p.sh. vendimet mbi;
- a) ushtrimin e të drejtave të tjera të aksionarit në Filiale;
 - b) ndonjë ndryshim ose mosvazhdim i Biznesit të Filialeve dhe/ose zhvillimi i ndonjë aktiviteti përveç aktiviteteve të Shoqërisë nga një Filial, duke përfshirë, por jo vetëm, likuidimin dhe mbylljen e ndonjë pjesë të Biznesit të Filialit;
 - c) shpërndarjen e funksioneve të biznesit të Shoqërisë tek Filialet;
 - d) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të Filialit;
 - e) miratimin dhe ndryshimin e rregulloreve për organet e Filialeve;
 - f) blerjen, disponimin dhe hipotekimin e Pasurive të paluajtshme të Filialeve;

7. dhënia e huave, bonove dhe benefiteve të tjera për të punësuarit e Shoqërisë;

8. blerja, disponimi dhe hipotekimi i pasurive të paluajtshme të Shoqërisë nëse akoma nuk janë miratuar në dokumentin e miratimit të kufirit të rrezikut të kredisë;

9. çdo çështje tjetër përtej zhvillimeve të zakonshme të biznesit ose të një rëndësisë të madhe për Shoqërinë dhe për Filialet.

§ 36. Drejtoria do të veprojë në përputhje me çfarëdolloj rregulloreje, udhëzimi dhe kërkesë të vendosur nga Këshilli Mbikqyrës herë pas here. Dispozitat për kryerjen e detyrave menaxhuese të Drejtorisë do të parashikohen në rregulloren e Drejtorisë që do të miratohet nga Këshilli Mbikqyrës.

§ 37. Për vendimet e Drejtorisë është i nevojshëm një quorum (prania) e të gjithë anëtarëve. Megjithatë, nëse janë të pranishëm më shumë se dy anëtarë të Drejtorisë do të jetë i nevojshëm vetëm një quorum i përbërë prej shumicës së thjeshtë të anëtarëve. Drejtoria do të vendosë në mënyrë unanime; nëse nuk arrihet ndonjë vendim në mënyrë unanime, Drejtoria do të raportojë menjëherë çështjen tek Këshilli Mbikqyrës i cili ka të drejtë të vendosë dhe të udhëzojë Drejtorinë.

38. Drejtoria do të mbledhet të paktën një herë në muaj në selinë e Shoqërisë se në ndonjë vend tjetër, në Shqipëri ose jashtë, dhe mbledhjet e saj mund të zhvillohen gjithashtu nëpërmjet videokonferencës, ose me anën e mjeteve elektronike të tjera të ngjashme, me kushtin që pjesëmarrësit të identifikohen dhe t'u jetë krijuar mundësia të ndjekin diskutimet dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në të. Nëse ekzistojnë kushte të tilla, Drejtoria mbahet në vendin ku ndodhen Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes, në mënyrë që të kryhet hartimi dhe firmosja e procesverbalit në regjistrin përkatës.

39. Kryetari thërret në mbledhje Drejtorinë, duke përcaktuar rendin e ditës, në çdo kohë që ai e konsideron të nevojshme ose në rastin kur merr një kërkesë me shkrim nga të paktën një anëtar i Drejtorisë ose i Këshillit Mbikqyrës. Kërkesa duhet të përmbajë listën e çështjeve ose subjekteve të cilëve u drejtohet. Nëse Kryetari refuzon të thërrasë një mbledhje dy ditë pas marrjes së kërkesës, mbledhja mund të thirret nga personi që ka kërkuar mbledhjen. Drejtoria do të thirret në mbledhje me anë të një letre rekomande, telegrami ose faksi të dërguar të paktën 3(tre) ditë para mbledhjes: në raste urgjente

mbledhja duhet të thirret një ditë para datës së caktuar për mbledhjen. Në rast se Kryetari mungon ose për arsye të tjera është i paafët të marrë pjesë në mbledhje, të gjitha funksionet e përmendura në këtë nen do t'i delegohen zëvendës Kryetarit, nëse ka, ose anëtarit më të vjetër. Mbledhja e Drejtorisë do të jetë e vlefshme edhe nëse njoftimi formal i thirrjes nuk ndodh, me kusht që të gjithë anëtarë të jenë të pranishëm.

40. Drejtoria mund të caktojë një Sekretar për të mbajtur procesverbalet dhe t'i vërtetojë ato me anën e firmës së tij së bashku me Kryetarin ose në rast se ai mungon, me një nga anëtarët e pranishëm. Sekretari mund të jetë edhe një person i cili nuk është anëtar i Drejtorisë. Procesverbalet mbahen në një regjistër të veçantë.

41. Procesverbali i mbledhjes së Drejtorisë do të mbahet në gjuhën shqipe dhe angleze dhe do të firmosen nga të gjithë anëtarët e Drejtorisë. Në rast mospërputhjeje midis versionit anglisht dhe shqip, versioni anglisht do të ketë përparësi.

42. Perfaqësimi i Shoqërisë:

1. Shoqëria do të përfaqësohet ligjërisht tek të tretët nga Kryetari i Drejtorisë, ose në mungesë të tij nga Zv. Kryetari i Drejtorisë. Në rast se Drejtoria përbëhet nga një Drejtor, ky i fundit do të ketë të drejtën e përfaqësimit të Shoqërisë tek të tretët.
2. Për transaksionet financiare në lidhje me veprimtarinë e qirasë financiare Shoqëria do të përfaqësohet bashkarisht nga një anëtar i Drejtorisë dhe një nëpunës i autorizuar për të nënshkruar në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Rregullat në lidhje me të drejtën e nënshkrimit në emër dhe për llogari të Shoqërisë do të përcaktohen nga Këshilli Mbikqyrës.
3. Drejtoria e parë e Shoqërisë përbëhet nga një Drejtor, kohëzgjatja e mandatit të të cilit është 4 (katër) vjet.
4. **Znj. Majlinda Hakani**, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 27.05.1967, banuese në Tiranë, në adresën Rr. Muhamet Gjollësja, Pall. 56/1/7, pas. N. 0777898; është emëruar Drejtore e Shoqërisë dhe për sa kohë që Drejtoria e Shoqërisë do të përbëhet nga një Drejtor, **Znj. Hakani** do të ketë të gjitha kompetencat dhe do të kryejë të gjitha detyrat që ky Statut ka parashikuar për Drejtorinë, Kryetarin dhe Zv. Kryetarin e Drejtorisë.

VIII. Administrimi i biznesit dhe llogaritë vjetore

§ 43. Viti financiar i Shoqërisë do të jetë viti kalendarik.

§ 44. Brënda tre muajve të parë të çdo viti financiar, Drejtoria duhet t'i paraqesë Këshillit Mbikqyrës llogaritë vjetore (duke përfshirë edhe bilancin dhe llogaritë fitim/humbje) për vitin financiar paraardhës të audituar nga ekspertë kontabël të autorizuar, një propozim për shpërndarjen dhe/ose për mënyrë tjetër përdorimi të fitimeve ose mbulimit të humbjeve, si dhe raportin vjetor të Shoqërisë. Të gjithë llogaritë vjetore dhe dokumentet e tjera të përmendura më sipër duhet të përpilohen sipas legjisllacionit shqiptar në fuqi si dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare.

§ 45. 1. Dividentët duhet të shpërndahen sipas vlerës së çdo aksioni. Dividentët që duhet t'i jepen aksionarëve të cilët janë rezidentë jashtë shtetit, sipas kërkesës së tyre, këmbehen

në monedhën e shtetit të aksionarëve, dhe/ose në ndonjë monedhë tjetër të këmbyeshme e cila është kërkuar nga aksionari në përputhje me ligjet e zbatueshme.

2. Përveç rasteve kur Asambleja e Aksionarëve ka vendosur ndryshe, dividendët duhet të shpërndahen brenda tre ditësh nga vendimi i Asamblesë që ka vendosur për ndarjen e tyre.

§ 46. 5% e fitimeve neto që rezultojnë nga bilanci i miratuar, sipas dispozitave ligjore kalojnë për rezervën ligjore derisa kjo shumë të arrijë vlerën 10% të kapitalit të Shoqërisë.

§ 47. Fitimet e mbetura shpërndahen sipas vendimeve të Asamblesë së Aksionarëve për shpërndarjen e dividendëve dhe zërave të tjerë.

IX. Kontrollorët

§ 48. Kontrolli i brendshëm i Shoqërisë kryhet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të emëruar për një vit ushtrimor.

§ 49. Kontrollorët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme.

§ 50. Kontrollore e Shoqërisë është zgjedhur shoqëria e të drejtës shqiptare KPMG Albania sh.p.k.

X. Likuidimi dhe Mbyllja

§ 51. Shoqëria konsiderohet e mbyllur në rast se verifikohen faktet e parashikuara nga ligji. Në rast mbyllje, Asambleja e jashtëzakonshme e Aksionarëve zgjedh një ose më shumë likuidatorë dhe u jep atyre kompetencat përkatëse.

§ 52. Shoqëria mund gjithashtu të shpërndahet apo të bashkohet me një tjetër me vendim të Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Aksionerëve.

§ 53. Ky Statut është hartuar dhe rregullohet sipas legjislacionit shqiptar.

§ 54. Të gjitha kontradiktat që lindin ose që lidhen me interpretimin i këtij Statuti, ndërmjet Aksionarëve ose midis një ose më shumë Aksionarëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe të drejtpërdrejtë midis palëve.

§ 55. Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin për ose në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin, shkeljen, përfundimin ose pavlefshmërinë e këtij Statuti midis aksionarëve, një aksionari dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në bazë të Rregullave të Arbitrazhit dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të Qendrës së Arbitrazhit të Dhomës Federale Ekonomike Austriake, Vienë, prej tre arbitrave të emëruar në bazë të këtyre rregullave. Vendi i arbitrazhit do të jetë Viena, Austri dhe gjuha që do përdoret në procesin e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze.

XI. Dispozita Përfundimtare

§ 56. Ky Statut përpilohet në 10 (dhjetë) kopje, 5 (pesë) prej të cilave janë në Anglisht dhe 5 (pesë) në Shqip. Në rast të ndonjë konflikti midis versioneve në gjuhë Angleze dhe Shqipe, versioni në Anglisht do të jetë mbizotërues.

§ 57. Në lidhje me çështjet që nuk janë rregulluar në këtë Statut, do të zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

* * * * *

Unë Noteri pasi lexova këtë Statut me zë të lartë Palëve të pranishme, jam e bindur se palët e gjejnë atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë dhe e firmosin lirisht para meje, dhe unë Noteri e vërtetoj atë sipas ligjit.

AKSIONARËT


Raiffeisen Bank sh.a.

Z. Steven Grunerud




Raiffeisen - Leasing International Gesellschaft m.b.H.

Znj. Rudina Ziu




NOTERE

Znj. Mimoza Sadushi



PERKTHYES

Znj. Edlira Cepani



STATUTI

Neni 1 Emërtimi i Shoqërisë

Raiffeisen – Leasing Gesellschaft m.b.H. dhe Znj. Adelheid Gerwing kanë vendosur të themelojnë një shoqëri me emërtimin-----
Raiffeisen – Leasing International Gesellschaft m.b.H.

Neni 2 Selia e Shoqërisë

Shoqëria do të ketë selin e saj në Vjenë, Austri.
Shoqëria mund të formojë degë në Austri dhe në vende të tjera.

Neni 3 Qëllimet e Shoqërisë

Qëllimet e shoqërisë janë:

- a. Të marri, të krijojë dhe menaxhojë asete të luajtshme dhe të paluajtshme në Austri dhe jashtë saj me qëllim kryerjen e operacioneve të qiradhënies dhe lisingu, veçanërisht për të fituar pasuri të paluajtshme dhe të drejta të tjera equivalente, të ndërtojë objekte mbi këto pasuri të paluajtshme për qëllime shfytëzimi dhe tregtare duke e dhënë në leasing këto pronësi dhe të drejtat ekuivalente ashtu si dhe ndërtesat;
- b. Të marri pjesë ose pjesëmarrje në ndërmarrje me të njëjtat qëllime si është parashikuar në paragrafin a) më lartë; dhe
- c. Të veprojë si agent në lidhje me transaksionet e kontraktuar nga të tjerët.

Shoqërisë nuk i lejohet të kryejë ndonjë transaksion bankar në kuptimin e parashikimeve statutore.

Neni 4 Kapitali dhe Pjesët e Kapitalit

Kapitali i shoqërisë është i barabartë me Euro 36.333,42 (tridhjetë e gjashtë mijë e treqind tridhjetë e tre presje dyzetë e dy) prej të cilave gjysma është paguar në kesh. Pjesa e çdo ortaku është e barabartë me pjesën përkatëse në kapital.

Neni 5 Pjesë e kapitalit

Tranferimi, pjestimi dhe lënia peng e pjesëve të kapitalit bëhet me miratimin e ortakëve.

Neni 6 Kohëzgjatja dhe Peridha Ushtrimore

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pakufizuar në kohë. Periudha e parë ushtrimore fillon me regjistrimin e shoqërisë në regjistrin tregtar dhe mbaronë me 31 dhjetorin e parë. Pas kësaj çdo periudhë financiare fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron më 31 dhjetorin pasardhës.

Neni 7 Organet e Shoqërisë

Organet e shoqërisë janë bordi i drejtorve dhe asambleja e ortakëve.

Neni 8 Bordi i Drejtorve

Shoqëria do të ketë të paktën dy drejtor. Shoqëria do të përfaqësohet nga dy drejtorët ose nga një prej drejtorve së bashku me një përfaqësues me prokurë, duke vepruar bashkarisht. Përfaqësimi i shoqërisë nga dy përfaqësues më prokurë, që veprojnë bashkarisht, lejohet dhe është subjekt i kufizimeve të përcaktuara në ligj. Përfaqësuesve me prokurë nuk mund tu jepet kompetenca për të vepruar veçmas.

Neni 9 Asambleja e Ortakëve

1. Asambleja e Ortakëve do të kërkohet prej drejtorëve ekzekutiv ose një ortaku. Asambleja e Ortakëve do të mbahet në Vienë ose në kryeqytetin e një prej provincave federale të Austrisë.
2. Vendimet e asamblesë së ortakëve mund të merren me shumicë të zkonshme, përveçse kur me ligj kërkohet me shumica të zakonshme.
3. Nëse në ndonjë rast të gjithë ortakët japin miratim me shkrim për një vendim, ose të paktën për marrjen e një vendimi me shkrim, ky vendim mund të merret me shkrim, me kusht që për këto vendime shumica e kërkuar nuk do të jetë shumica e votave të mbledhura, por shumica e votave të gjithë ortakëve.
4. Cdo 1 (një) euro cent e kapitalit të ortakëve korespondon me një votë, por cdo ortak duhet të ketë të paktën një votë.

Neni 10 Deklaratat Financiare Vjetore

- (1) Drejtorët ekzekutiv brënda pesë muajve të parë të çdo viti financiar, do të përgatisin deklaratat financiare vjetore të vitit financiar paraardhës.

(2) Cdo vit Asambleja e ortakëve do të marrë një vendim në lidhje me aprovimin e deklaratave financiare vjetore, shpërndarjen e përfitimeve neto, dhe mbi vendimet e drejtorëve ekzekutiv për vitin financiar parardhës (asambleja vjetore e ortakëve)

(3) Asambleja e ortakëve mund të vendos me unanimitet mbi një shpërndarje të fitimeve që nuk është në përpjestim me pjesmarjen e tyre në kapital.

Neni 11 Dispozita të tjera

Përveçse kur parashikohet ndryshe nga kjo kontratë, do të zbatohetn dispozitat e Aktit Australian mbi Shoqëritë me Përgjegjësi të kufizuar dhe ligjet të tjera të aplikueshme.

Me kontrollin e sotëm të dosjes nr. FN 157024v të Raiffeisen-Leasing International Gesellschaft m.b.H. në Regjistrin e Shoqërive të Gjykatës Tregtare të Vienës, unë me anë të kësaj vërtetohet në përputhje me seksionin 9 b të Aktit të Noterit Public që formulimi dhe format e Neneve të Statutit të dhëna këtu më sipër pajtohen me kopjen originale aktualisht të skeduar në Regjistrin e Shoqërive.

Vienë, 28 (njëzetë e tetë) Shkurt 2006 (dy mijë e gjashtë)

Dr. Christoph Bieber
Noter publik
Vienë-Qyteti I Brëndshëm

Vulë:
(nënshkrim i palexueshëm)
Noter Publik

Në mirëbesim me anë të kësaj
Vërtetohet që sa më lartë është një
Përkthim i rregullt i tekstit Gjermanisht
bërë prej meje.

Vienë, 3 Mars 2006

Vula

VËRTETIM

Sot, më datë 09.05. 2006, unë e nënshkruara, Gentiana Koduzi, qytetare shqiptare, lindur në Lushnjë më 03.07.1980 dhe banuese në Tiranë, Rr. Kavaja, P. 138, me pasaportë nr. Z 1347741, vërtetoj që deklarova se versioni shqip i dokumentit bashkëngjitur është një përkthim i njëjtë me origjinalin i versionit anglisht dhe anasjelltas.

PËRKTHYESE

Gentiana Koduzi
Gentiana Koduzi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR. 2783 REP.

PULLE TAKSE



VËRTETIM

Unë vërtetoj se sot më datë 09.05. 2006, në Zyrën e Noterisë, para meje Noteres *Mimoza Sadushaj*, u paraqit personalisht Znj. Gentiana Koduzi, qytetare shqiptare, lindur në Lushnjë më 03.07.1980 dhe banuese në Tiranë, Rr. Kavaja, P. 138, me pasaportë nr. Z 1347741, e njohur personalisht prej meje, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e së cilës u binda pasi verifikova pasaportën e saj, e cila më deklaroi se versioni shqip i dokumentit bashkëngjitur është një përkthim i njëjtë me origjinalin i versionit anglisht dhe anasjelltas, vërtetim të cilin e nënshkroi përpara meje noteres, me vullnetin e saj të plotë dhe të lirë, dhe unë e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERE




NOTERE
Mimoza Sadushaj
TIRANË

STATUTI

I

"Raiffeisen Bank" Sh.A.



Neni 1 Emërtimi dhe Selia e Bankës

- (1) Emërtimi i Bankës është "Raiffeisen Bank" Sh.A. (si më poshtë "Banka").
- (2) Selia e Bankës është në Rrugën e Kavajës, Tiranë.
- (3) Banka është rregjistruar në Regjistrin Tregtar si shoqëri anonime e krijuar në përputhje me legjislacionin shqiptar. Kohëzgjatja e Bankës është e pakufizuar.
- (4) Banka ka stemë dhe vulë zyrtare.
- (5) Banka ka të drejtë të hapë degë, filiale, apo zyra përfaqësimi, në Shqipëri ose jashtë shtetit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe në përputhje me veprimtarinë e saj sipas liçencës bankare të Bankës.

Article 2

Objekti i veprimtarisë së Bankës

- (1) Objekti i veprimtarisë së Bankës është të ushtrojë veprimtari bankare dhe finciare si dhe çdo veprimtari tjetër të lidhur me to në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me veprimtarinë e saj sipas liçencës bankare të Bankës të lëshuar nga Banka e Shqipërisë. Në mënyrë të veçantë, Banka ka të drejtë të kryejë veprimtaritë e mëposhtme:
 - a) të pranojë dhe të grumbullojë depozita bankare;
 - b) të japë kredi;
 - c) të marrë hua mjete finciare dhe të blejë ose të shesë për llogari të saj apo për llogari të klientëve:
 - (i) instrumente të tregut të parave;
 - (ii) letra me vlerë të borxhit;
 - (iii) kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata me kusht (option), që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose me normat e interesit; ose
 - (iv) instrumentet e normës së interesit;
 - d) të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve;
 - e) të emetojë, të pranojë dhe të administrojë mjete të pagesave;
 - f) të ndërmjetësojë për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
 - g) të ushtrojë qeranë finciare;
 - h) të ofrojë shërbimin e kasave të sigurimit;
 - i) të ofrojë garanci bankare dhe garanci të tjera;
 - j) të ofrojë shërbime si agjent financiar ose këshilltar financiar (jo për shërbimet e parashikuara në paragrafin në (a) and (b) të këtij neni);

- k) të ushtrojë veprimtari bankare me metalet e çmuara;
- l) të ushtrojë këmbimin e valutave, duke përfshirë edhe kontratat e së ardhmes (futures) për këmbime valutore;
- m) të ushtrojë shërbime besimi (trust), përfshirë, pa kufizim, investimin dhe administrimin e fondeve të besuara (fiduciare);
- n) të ushtrojë shërbime si administruese e portofolit të investimit ose të këshilltarit për investimet;
- o) të ushtrojë shërbime për nënshkrimin dhe shpërndarjen e letrave me vlerë të borxhit dhe të pronësisë, si dhe tregtimin e letrave me vlerë të pronësisë për llogari të saj ose të klientëve;
- p) të ushtrojë çdo veprimtari tjetër financiare të lidhur apo plotësuese me veprimtarinë bankare të përcaktuar në licencë dhe/apo në aktet nënligjore nga Banka e Shqipërisë.

- (2) Banka ka të drejtë të ndërmarrë çdo veprim tjetër që është i dobishëm ose i nevojshëm për realizimin e objektivit të Bankës në përputhje me ligjin siç mund të ndryshohet herë pas here.

Neni 3

Kapitali aksionar dhe Aksionet

- (1) Kapitali aksionar i Bankës është 25 497 462,10 (njëzet e pesë milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy presje 10) Euro.
- (2) Kapitali aksionar i Bankës është ndarë në 7.000 (shtatë mijë) aksione nominative pa vlerë specifike nominale. Vlera përkatëse nominale e çdo aksioni nominativ llogaritet nga kapitali i shoqërisë pjestuar me numrin ekzistues të aksioneve nominative. Aksioni mund të emetohet si aksion me përparësi, i zakonshëm ose me të drejta të tjera speciale ose me kufizime, në lidhje me dividentin, të ardhurat e kapitalit, votat ose të drejta të tjera të përcaktuara nga Banka në Asamblenë e Jashtëzakonshme të Aksionarëve dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- (3) Kapitali i nënshkruar aksionar shlyhet në para me kërkesë të Këshillit Drejtues brenda afatit të përcaktuar me ligj.
- (4) Aksionet transferohen në përputhje me dispozitat ligjore mbi aksionet nominative.
- (5) Forma dhe përmbajtja e certifikatave të aksioneve (ose certifikatave të ndërmjetme), përcaktohet me vendim të Këshillit Drejtues në përputhje me ligjin shqiptar.
- (6) Çdo person fizik ose juridik me vendbanim ose seli brenda ose jashtë Shqipërisë mund të zotërojë aksione në kapitalin e Bankës; Banka mban një regjistër

aksionarësh në të cilin shënohen emri/emërtimi dhe adresa e çdo aksionari dhe numri i aksioneve të zotëruara përkatësisht.

Neni 4 Organet e Bankës

Banka organizohet si më poshtë:

- a) Asambleja e Aksionarëve;
- b) Këshilli Drejtues;
- c) Drejtoria.

Neni 5 Asambleja e Aksionarëve

- (1) Asambleja e Aksionarëve është organi më i lartë suprem vendim-marrës i Bankës dhe përbëhet nga të gjithë aksionarët e Bankës. Asambleja e Aksionarëve është e Zakonshme ose e Jashtëzakonshme.
- (2) Asambleja e Zakonshme e Aksionarëve ka të drejtë të marrë të gjitha vendimet që lidhen me çështjet që bëjnë pjesë në kompetencat e saj në përputhje me ligjin përveç atyre vendimeve që merren posaçërisht nga Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionarëve.
- (3) Si rregull i përgjithshëm, Asambleja e Aksionarëve mbahet në selinë e Bankës. Megjithatë, mbledhja e Asamblesë mund të mbahet edhe në ndonjë vend tjetër, në Shqipëri apo jashtë saj.
- (4) Asambleja e Aksionarëve i bën të ditura vendimet e saj me akt vendim-marrës, i cili është detyrues për organet kolektive apo individuale të Bankës.
- (5) Asambleja e Aksionarëve thirret nga Këshilli Drejtues ose Drejtoria. Në mungesë të thirrjes nga këto organe, Asambleja e Aksionarëve thirret gjithashtu sipas procedurave të parashikuara nga legjisllacioni në fuqi.
- (6) Njoftimi i thirrjes së Asamblesë së Aksionarëve, i cili përmban qëllimin apo qëllimet e mbledhjes, vendin dhe kohën e mbajtjes së saj, i dërgohet me letër rekomande secilit prej aksionarëve të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara mbledhjes në fjalë.
- (7) Asambleja e Aksionarëve konsiderohet se është mbledhur rregullisht edhe në rast se nuk janë respektuar procedurat që lidhen me thirrjen, me kusht që të jenë të pranishëm apo të përfaqësuar me prokurë të gjithë zotëruesit e kapitalit aksionar. Vendimet e Asamblesë së Aksionarëve mund të merren gjithashtu nëpërmjet konsultimit me shkrim të aksionarëve që pranojnë po këtë procedurë.

(8) Aksionarët mund të zgjedhin që të përfaqësohen në Asamblenë e Aksionarëve, me prokurë me shkrim, nga ndonjë aksionar tjetër apo person i tretë.

Të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Aksionerëve kryesohen nga Kryetari i Këshillit Drejtues ose në mungesë të tij nga Zëvendës-Kryetari, ose, nëse këta persona nuk janë të disponueshëm, nga një Anëtar i Këshillit Drejtues ose edhe nga një aksionar i caktuar nga Asambleja e Aksionarëve. Asambleja e Aksionarëve cakton një sekretar të mbledhjes, i cili mund të mos jetë aksionar.

(10) Përveç kompetencave të përcaktuara në dispozitat ligjore, Asambleja e Aksionarëve ushtron kompetencat ekskluzive si më poshtë:

- a) ndryshimet dhe plotësimet e Statutit;
- b) vendimet mbi zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit aksionar të Bankës;
- c) vendimet mbi emetimin e obligacioneve, përveç rastit kur Asambleja e Aksionarëve autorizon Këshillin Drejtues për emetimin e obligacioneve;
- d) miratimin e llogarive vjetore dhe vendimin mbi shpërndarjen e fitimit vjetor dhe sistemimin e humbjeve;
- e) lirimimin nga përgjegjësia e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe të anëtarëve të Komitetit të Kontrollit;
- f) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues;
- g) vendimet për kompensimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues;
- h) emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar të Bankës;
- i) vendimet mbi bashkimin, shkrirjen ose likuidimin e Bankës.

Neni 6

Asambleja e Zakonshme e Aksionarëve

- (1) Asambleja e Zakonshme e Aksionarëve thirret të paktën një herë në vit, brenda gjashtë muajve nga mbyllja e vitit financiar, me qëllim që të diskutojë, shqyrtojë dhe miratojë llogaritë vjetore të vitit parardhës financiar.
- (2) Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve konsiderohet e mbledhur rregullisht, në thirrjen e saj të parë, nëse janë të pranishëm apo të përfaqësuar, aksionerët që zotërojnë të paktën 25% (njëzetë e pesë përqind) të aksioneve me të drejtë vote. Në rast se nuk arrihet ky *quorum*, duhet të mbahet një mbledhje e dytë për të cilën nuk është i nevojshëm asnjë *quorum*. Asambleja e Zakonshme e Aksionarëve merr vendim me shumicën e aksionerëve të pranishëm apo të përfaqësuar.

Article 7

Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionarëve

- (1) Vetëm Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionarëve vendos për ndryshime në Statutin e Bankës, ose për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit aksionar të Bankës.
- (2) Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionarëve konsiderohet e mbledhur rregullisht, në thirrjen e saj të parë, nëse janë të pranishëm apo të përfaqësuar, aksionarët që zotërojnë të paktën 50% (pesëdhjetë përqind) të aksioneve me të drejtë vote, dhe në thirrjen e dytë nëse janë të pranishëm apo të përfaqësuar, aksionarët që zotërojnë të paktën 25% (njëzetë e pesë përqind) të aksioneve me të drejtë vote.
- (3) Në rast se nuk arrihet ky *quorum*, thirrja e dytë mund të shtyhet në një datë të mëvonshme, por jo më vonë se dy muaj nga data e thirrjes së parë.
- (4) Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionarëve merr vendim me shumicën e 3/4 (tre të katërtave) të aksionarëve, të pranishëm apo të përfaqësuar.

Neni 8

Këshilli Drejtues

- (1) Këshilli Drejtues është përgjegjës për formulimin dhe zbatimin e politikave si dhe për mbikqyrjen e veprimtarisë financiare dhe tregtare të Bankës.
- (2) Këshilli Drejtues i Bankës përbëhet nga një numër tek anëtarësh, jo më pak se 5 (pesë). Anëtarët e Këshillit Drejtues caktohen nga Asambleja e Aksionarëve për një afat prej jo më shumë se 4 (katër) vite. Anëtarët e Këshillit Drejtues mund të ri-emërohen për afate e tjera pasuese. Anëtarët e Këshillit Drejtues mund të shkarkohen me vendim të Asamblesë së Zakonshme të Aksionarëve.
- (3) Në rast të ndonjë vendi bosh në Këshillin Drejtues për shkak vdekje, shkarkimi, dorëheqje, skualifikimi apo ndonjë shkak tjetër (si më poshtë "vendi bosh"), vendi bosh zëvendësohet brenda 3 (tre) muajve. Zëvendësuesit propozohen nga anëtarët ekzistues të Këshillit Drejtues. Në rastet e vendit bosh, anëtarët ekzistues të Këshillit Drejtues thërrasin menjëherë Asamblenë e Aksionarëve për të miratuar emërimin e zëvendësuesit. Zëvendësuesit janë në detyrë deri në përfundimin e mandatit të personit të zëvendësuar.
- (4) Asambleja e Aksionarëve mund të vendosë mbi shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues.
- (5) Këshilli Drejtues mbledhet të paktën dy herë në vit dhe në çdo rast sipas ecurisë së veprimtarisë të Bankës dhe në të gjitha rastet e parashikuara nga ligji.
- (6) Këshilli Drejtues miraton rregullat e brendshme të funksionimit duke rregulluar mënyrën e kryerjes së detyrave dhe ushtrimin e veprimtarive monitoruese.

Neni 9 Komitetet e Këshillit Drejtues

- (1) Pavarësisht nga përgjegjësia kolektive, Këshilli Drejtues gëzon të drejtën të krijojë midis anëtarëve të tij komitete që përbëhen nga të paktën tre anëtarë duke përcaktuar detyrat dhe rregullat e funksionimit të brendshëm.
- (2) Anëtarët e komiteteve emërohen nga Këshilli Drejtues për një periudhë që korrespondon me afatin e detyrës së tyre si anëtarë të Këshillit Drejtues, përveç rastit kur parashikohet ndryshe në emërim.

Neni 10 Drejtoria

- (1) Veprimtaria dhe punët e përditshme të Bankës drejtohen nga Drejtoria, në interes të aksionarëve. Drejtoria vendos mbi të gjitha veprimtaritë e Bankës, me përjashtim të rastit kur këto veprimtari janë kompetencë të Asamblesë së Aksionarëve ose të Këshillit Drejtues.
- (2) Drejtoria përbëhet prej më shumë se dy anëtarë të zgjedhur nga Këshilli Drejtues. Këshilli Drejtues ka të drejtë të shkarkojë anëtarët e Drejtorisë.
- (3) Këshilli Drejtues emëron një Kryetar dhe një Zëvendës-Kryetar midis anëtarëve të Drejtorisë.
- (4) Në lidhje me sa më sipër, Këshilli Drejtues gëzon të drejtën të vendosë mbi të gjithë çështjet ligjore në lidhje me marrëdhëniet ligjore ndërmjet anëtarëve të Drejtorisë dhe Bankës dhe marrëdhëniet ligjore që kanë të bëjnë me emërimin, largimin, ose shkarkimin e anëtarëve të Drejtorisë.
- (5) Këshilli Drejtues, nëpërmjet Rregullores të brendshme të Drejtorisë ose vendimeve të posaçme, ka të drejtë të kufizojë kompetencat e Drejtorisë; këto kufizime, sidoqoftë, nuk do të jenë të vlefshme për të tretët.
- (6) Vendimet e Drejtorisë kërkojnë *quorumin* e pranisë së shumicës së të gjithë anëtarëve të tij. Drejtoria vendos unanimisht.
- (7) Drejtoria mbledhet të paktën 3 here në muaj. Dispozitat mbi kryerjen e detyrave drejtuese përcaktohen në Rregulloren e brendshme të Drejtorisë e cila miratohet nga Këshilli Drejtues.

Neni 11 Përfaqësimi i Bankës

- (1) Banka përfaqësohet nga dy anëtarë të Drejtorisë, ose nga një anëtar i Drejtorisë së bashku me një nëpunës të autorizuar të nënshkruajë për llogari të Bankës.
- (2) Dhënia e kompetencave të nënshkrimit ose të përfaqësimit një personi të vetëm për të gjithë veprimtarinë e Bankës është e ndaluar.
- (3) Kompetencat e nënshkrimit për llogari të Bankës përcaktohen nga Drejtoria në rregullat e brendshme mbi kompetencat e nënshkrimit dhe miratohen nga Këshilli Drejtues.
- (4) Drejtuesit e njësive organizative (divizione) si dhe drejtorët e degëve të Bankës janë nën vartësinë e Drejtorisë. Në detyrën e tyre si nëpunës me kompetenca nënshkrimi ata janë përgjegjës për administrimin e njësive organizative (divizione) dhe degëve si dhe janë të autorizuar të përfaqësojnë Bankën në lidhje me çështjet e përcaktuara nga Drejtoria sipas paragrafit 3 të këtij neni.
- (5) Përfaqësuesit ligjorë të lartpërmendur të Bankës, kanë të drejtë të emërojnë një përfaqësues "*ad negotia*" për kryerjen e detyrave të veçanta ose të kategorive të detyrave, brenda kufijve të kompetencave të dhëna.

Neni 12 Komiteti i Kontrollit

- (1) Banka ka një Komitet Kontrolli.
- (2) Komiteti i Kontrollit përbëhet nga tre anëtarë të emëruar nga Asambleja e Aksionerëve që ka detyrat si më poshtë:
 - a) Kontrollon dhe mbikëqyr procedurat kontabël dhe të kontrollit të brendshëm të bankës, duke përfshirë procedurat e vendosura nga Banka e Shqipërisë, si dhe mbikëqyr zbatimin e këtyre procedurave dhe kontrollon llogaritë bankare dhe regjistrimet përkatëse;
 - b) Kontrollon zbatimin e rregulloreve e të akteve të tjera dhe i raporton Këshillit Drejtues të Bankës;
 - c) Jep mendime për të gjitha problemet që i kërkohen nga Këshilli Drejtues i Bankës.
- (3) Komiteti i Kontrollit mbledhet rregullisht çdo tremujor të vitit në mbledhje të zakonshme dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë thirret nga Këshilli Drejtues i Bankës. Mbledhjet mund të mbahen në Shqipëri apo jashtë saj. Vendimet merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm. Nuk lejohen abstenime.

- (4) Me kërkesën e tij, Komiteti i Kontrollit mund të asistohet nga dy ekspertë të emëruar nga Këshilli Drejtues i Bankës.
- (5) Asambleja e Aksionarëve të Bankës përcakton shpërblimin për anëtarësinë në Komitetin e Kontrollit.
- (6) Komiteti i Kontrollit miraton rregullat e brendshme të funksionimit duke rregulluar mënyrën e kryerjes së detyrave dhe ushtrimin e veprimtarive të kontrollit.

Neni 13

Llogaritë, Kontrolli i Jashtëm dhe Inspektimi

- (1) Banka mban llogaritë kontabël të duhura dhe përgatit raportet financiare, për të pasqyruar saktë dhe në përputhje me rregullat e metodat kontabël gjenden e saj financiare. Llogaritë kontabël dhe raportet financiare duhet të jenë në formë dhe përmbajtje në përputhje me standardet kontabël kombëtare dhe ndërkombëtare.
- (2) Viti financiar i Bankës është viti kalendarik. Viti i parë kalendarik fillon me regjistrimin e Bankës në Rregjistrin Tregtar.
- (3) Asambleja e Zakonshme e Aksionerëve emëron një ose më shumë ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët duhet :
 - a) të ndihmojnë Bankën për mbajtjen në mënyrën e duhur të llogarive kontabël dhe të regjistrimeve financiare, të parashikuara nga ligji;
 - b) të përgatisin raport vjetor së bashku me opinionet e kontrollit, lidhur me paraqitjen e plotë dhe të saktë të gjendjes financiare të Bankës të përgatitura në përputhje me ligjin;
 - c) të shqyrtojnë mjaftueshmërinë e kontrollit të brendshëm dhe të praktikave e procedurave kontrolluese, si dhe të bëjnë rekomandimet përkatëse.

Eksperti kontabël i autorizuar ka të drejtë:

- a) të kontrollojë dhe të shqyrtojë llogaritë kontabël, librat e shoqërisë, dokumentet dhe çdo të dhënë tjetër në arkivat e bankës;
 - b) të kërkojë në çdo kohë nga administratorët, nëpunësit dhe agjentët e bankës të japin informacione për çështje që lidhen me administrimin, drejtimin dhe operacionet. Informacionet përgatiten në formën e parashikuar nga ekspertët kontabël të autorizuar.
- (4) Bilanci kontabël i Bankës, raporti vjetor financiar dhe raporti i ekspertit kontabël të autorizuar për vitin financiar botohen në buletin zyrtar të Bankës.

Neni 14 Shpërndarja e fitimit

- (1) Dividentët që u takojnë aksionarëve me vendbanim jashtë shtetit do t'u transferohen, me kërkesën e tyre, në monedhën e vendit përkatës.
- (2) Dividenti deklarohet nga Këshilli Drejtues në bazë të vendimit të Asamblesë së Aksionarëve sipas ligjit. Herë pas here, Këshilli Drejtues në përputhje me legjislacionin në fuqi, përpara pagesës së një dividenti, vendos mënjanë prej fondit të dividentëve atë shumë që e gjykon për fondin rezervë për t'i përdorur për rrethana të paparashikuara ose për të barazvlerësuar dividentët, ose për ndonjë qëllim tjetër të cilin Këshilli Drejtues e konsideron të arsyeshëm dhe në interes të Bankës.
- (3) Përveç rastit kur Asambleja e Aksionarëve përcakton ndryshe, dividentët janë të pagueshme ditën pasuese të mbledhjes së Asamblesë vjetore të Aksionarëve.

Neni 15 Publikimet e Bankës

Botimet e Bankës si dhe proces-verbalet e vendimeve të organeve të Bankës të parashikuara nga Statuti mbahen në Anglisht. Në rast se ligji kërkon që botimet dhe/ose mbajtja e proces-verbaleve të bëhet në shqip, aksionerëve ose anëtarëve të organit përkatës të Bankës i jepet përkthimi i dokumentit në fjalë në anglisht. Në rast mosmarrëveshje mbi interpretimin e dokumenteve të filla versioni Anglisht ka përparësi për Bankën dhe aksionarët.

Wien, am 19. NOV. 2004

Raiffeisen International Bank-Holding AG


 Mr. Heinz Hödl


 Mrs. Katharina Käffinger

B. Z. 2004/13646

Die Echtheit vorstehender Gesamtfirmazeichnung des Herrn Heinz Hödl als Vorstandsmitglied und der Frau Mag. Renate Kattinger als Gesamtprokuristin der Raiffeisen International Bank-Holding AG (FN 122119m), mit dem Sitz in Wien und der Geschäftsanschrift in 1030 Wien, Am Stadtpark 9 wird bestätigt. Auf Grund der heute vorgenommenen Einsichtnahme in das Firmenbuch bestätige ich gemäß Paragraph neunundachtzig a Notariatsordnung die gemeinsame Vertretungsberechtigung der Vorgenannten für die unter FN 122119m eingetragene Raiffeisen International Bank-Holding AG, mit dem Sitz in Wien. -----
Wien, am 19.(neunzehnten) November 2004 (zweitausendvier) -----
Gebühr € 13,- (Euro dreizehn) entrichtet. -----



DRW
öff. Notar



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. J.333 Regj.
Vërtetohet fotokopja
me origjinalin
TIRANE 26.11.2004

Hammer Ludwig
[Signature]

B.Z. 2004/13646

Nëpërmjet këtij akti vërtetohet se firmat e Z. Heinz **Hödl** që vepron në anëtarit të Drejtorisë dhe Znj. **Magister Renate Kattinger** që vepron në cilësinë e saj të "Zyrtarit të autorizuar që ka titull të përfaqësimit të përbashkët" të Raiffeisen International Bank-Holding AG (Shoqëri me numër regjistrimi 122119m) me seli ligjore në Vienë, 1030 dhe adresë në ~~Am~~ Stadtpark 9, janë autentike. Në vijim të kontrollit të kryer ditën e sotme pranë Regjistratit të Shoqërive Tregtare, unë vërtetohet, në përputhje me seksionin tetëdhjetë e nëntë të Rregullores së Noterëve Publikë, se zyrtarët e sipërsënuar janë të autorizuar të përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë Raiffeisen International Bank-Holding AG, shoqëri e regjistruar me numrin 122119m dhe me seli ligjore në Vienë.-----

Vienë, më 19 (nëntëmbëdhjetë) nëntor 2004 (dymijë e katër).-----

Tarifa 13 euro,-- (trembëdhjetë euro) të paguara -----

Vula

Firma
Dr. Christoph Bieber
Noter

VËRTETIM

Sot, më datë 26. 11. 2004, unë e nënshkruara, Gentiana Koduzi, qytetare shqiptare, lindur në Lushnjë më 03.07.1980 dhe banuese në Tirane, Rr. Kavaja, P. 138, me pasaportë nr. 1444041, vërtetoj që deklarova se versioni shqip i dokumentit bashkëngjitur është një përkthim i njëjtë me originalin i versionit anglisht dhe gjermanisht dhe anasjelltas.

PËRKTHYËSE

Gentiana Koduzi
Gentiana Koduzi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR. 5334 REP.

VËRTETIM

Unë vërtetoj se sot më datë 26. 11. 2004, në Zyrën e Noterisë, para meje Noteres *Elvira Saolli* u paraqit personalisht Znj. Gentiana Koduzi, qytetare shqiptare, lindur në Lushnjë më 03.07.1980 dhe banuese në Tirane, Rr. Kavaja, P. 138, me pasaportë nr. 1444041, e njohur personalisht prej meje, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e së cilës u binda pasi verifikova pasaportën e saj, e cila më deklaroi se versioni shqip i dokumentit bashkëngjitur është një përkthim i njëjtë me originalin i versionit anglisht dhe gjermanisht dhe anasjelltas, vërtetim të cilin e nënshkroi përpara meje noteres, me vullnetin e saj të plotë dhe të lirë, dhe unë e vërtetoj atë sipas ligjit.



NOTERE

Elvira Saolli
Elvira Saolli

Z. M. Medhi
04.05.2006
[Signature]



04 MAJ 2006 KËRKESË

100 LEKE
R.SHQIPËRISE
PULLE TAKSE

RKUES:

Shoqëria "Raiffeisen Leasing" sh.a., (shoqëri ne krijim e sipër), (më poshtë referuar si "Shoqëria"), e përfaqësuar nga Znj. **Majlinda Hakani**, e bija e Luanit, shtetase shqiptare, lindur më 27 Maj 1967, në Tiranë, banuese në Rr. "Myslym Shyri", Pall. 56/1/7, Tiranë, Shqipëri, me nr. pashaporte n. 0777898, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, në cilësinë e Drejtores së Shoqërisë.

100 LEKE
R.SHQIPËRISE
PULLE TAKSE

EKTI:

Rregjistrimi si person juridik pranë Rregjistrimit Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Shoqërisë "Raiffeisen Leasing" sh.a.

100 LEKE
R.SHQIPËRISE
PULLE TAKSE

A LIGJORE:

Ligji nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" si dhe të Ligji nr. 7667 datë 28.01.1993 "Për Regjistrimin Tregtar dhe Formalitetet që duhen Respektuar nga Shoqëritë Tregtare".

100 LEKE
R.SHQIPËRISE
PULLE TAKSE

COMPETENCË

GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
SEKSIONI TREGTAR

Pa regjistruar
akti i statutit
17
[Signatures]

100 LEKE
R.SHQIPËRISE
PULLE TAKSE

raiffeisen Bank sh.a., ("RBAL"), një bankë që është themeluar dhe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe **Raiffeisen - Leasing International Gesellschaft** sh.a., ("RLI"), një shoqëri që është themeluar dhe funksionon sipas ligjeve të Austrisë, themeluar një shoqëri anonime sipas të drejtës shqiptare që do të ushtrojë veprimtarinë e saj në fushën e qirasë financiare.

100 LEKE
R.SHQIPËRISE
PULLE TAKSE

Emri i Shoqërisë është "Raiffeisen Leasing" sh.a., dhe kohëzgjatja e saj është e përhershme.

100 LEKE
R.SHQIPËRISE
PULLE TAKSE

Adresa e ka selinë në adresën Rr. Kavajës, Tiranë.

100 LEKE
R.SHQIPËRISE
PULLE TAKSE

Veprimtaria e veprimtarisë së Shoqërisë është:

- a) ushtrimi i veprimtarisë së qirasë financiare, qiradhënia financiare e sendeve të luajtshme dhe pasurive të paluajtshme, dhe
- b) blerja e sendeve me qëllim rishitjen e tyre, dhe
- c) financimi ose kredidhënia në funksion të veprimtarisë së qirasë financiare, dhe
- d) të gjitha veprimtaritë e tjera të biznesit të lidhura apo plotësuese, të cilat mund të jenë të nevojshme (duke përfshirë ndër të tjera, shërbime regjistrimi, ndërmjetësim në sigurime, menaxhim ndërtimesh dhe të infrastrukturave që lidhen me to për pasuri të paluajtshme ose kryerja e shërbimeve të tjera që lidhen me objektet e dhëna në qira financiare).


100 LEKE
R.SHQIPËRISE
PULLE TAKSE

100 LEKE
R.SHQIPËRISE
PULLE TAKSE

100 LEKE
R.SHQIPËRISE
PULLE TAKSE

100 LEKE
R.SHQIPËRISE
PULLE TAKSE

100 LEKE
R.SHQIPËRISE
PULLE TAKSE



Kapitali i Shoqërisë është 123 000 000 ALL (Lekë Shqiptare) (njëqind e njëzetetë milionë lekë) ose 1 000 0000 Euro (një milionë Euro) dhe ndahet në 1000 (njëmijë) aksione me vlerë nominale prej 123 000 ALL (njëqind e njëzet e tre mijë lekë) secila ose 1 000 Euro (njëmijë Euro) secila. Cdo aksion është i pandashëm dhe përbën të drejtën e një vote.

Aksionet ndahen si më poshtë:

- a) **RBAL: 750** aksione (shtatëqind e pesëdhjetë) me vlerë nominale 92 250 000 ALL (nëntëdhjetë e dy milionë dyqind pesëdhjetë mijë lekë) ose 750 000 Euro (shtatëqind pesëdhjetë mijë).
- b) **RLI: 250** aksione (dyqind e pesëdhjetë) me vlerë nominale 30 750 000 ALL (tridhjetëmilionë shtaëqind e pesëdhjetë mijë Lekë) ose 250 000 Euro (dyqind pesëdhjetë mijë).

Aksionet janë nënshkruar nga aksionerët dhe janë paguar totalisht prej tyre në llogarinë bankare nr.1000 555551, pranë Raiffeisen Bank sh.a. që është celur për këtë qëllim.

Organet Drejtuese të Shoqërisë janë:

- **Asambleja e Aksionerëve;**
- **Këshilli Mbikqyrës;**
- **Drejtoria.**

Organizimi dhe funksionimi i këtyrë organeve rregullohet në statutin e Shoqërisë, ku parashikohen gjithashtu rregullat e funksionimit të Shoqërisë.

Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 3 (tre) ose më shumë anëtarë. Personat e mëposhtëm janë emëruar anëtarë të Këshillit Mbikqyrës të parë të Shoqërisë:

1. **Z. Dieter Schiedl**, shtetas Austriak, lindur në Gmuend, Austria, më 11.09.1967, me pas.nr. A 0087535, banues në Huglgasse 11/7, 1150 Vienna, Austria;
2. **Z. Steven Gordon Grunerud**, shtetas Kanadez, lindur në Vankuver, Kanada, më 3 Prill 1963, me pas.nr. BC16338, banues në Tirane, Shqiperi;
